FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIA DEVELOPMENT FUND

RIKUALIFIKIM URBAN I ZONËS TURISTIKE, GOLEM - LOT I

Raporti i Projekt Zbatimit

Shtator, 2020

KONSULENTI: ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS

Porositësi:	**Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
Konsulenti:	**Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.**
Objekti:	**Rikualifikim Urban i Zonës Turistike, Golem - Lot I**
Titulli i Dokumentit:	**Raporti i Projekt Zbatimit**
Faza e Projektit:	**Projekt Zbatimi**
Kodi i dokumentit:	**ICE-287-P01-V1 03**

Rish.	**Qëllimi i Dorëzimit**	**Shënime**	**Data**
00	Për miratim		26.09.2020

	KONSULENTI			**POROSITËSI**	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Vasil Leka Alban Doko Dritan Bratko Taulant Karriqi Ramush Dumani Amarildo Shehu	Olset Haxhiu Blenard Durmishi Fisnik Kruja Giovanni Di Fisco Kujtim Proseku			
Data:	24.08.2020	25.09.2020	25.09.2020		
Statusi i Dokumentit:	**Përfundimtar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**

Tiranë 2020

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja ..... **i**
Lista e Tabelave ..... **ii**
Lista e Figurave ..... **iii**
1 Hyrje **1**
2 Korespondenca **3**
3 KRITERET E PROJEKTIMIT **6**
3.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike 6
3.2 Parametrat e projektimit 6
4 Konsideratat për Projektimin e rrugës **7**
4.1 Gjendja ekzistuese 7
4.1.1 Segmenti 1/3 – 3 7
4.1.2 Segmenti 5 – 6 8
4.1.3 Segmenti 3 – 5 – 13/1 (kanal-Nënkalimi Golemit) 9
4.1.4 Segmenti 9 – 10 10
4.1.5 Rrugët e tjera lokale 11
4.2 Projektimi Gjeometrik 12
4.3 Shtresat rrugore 12
4.4 Konsiderata për projektimin strukturor 13
4.4.1 Ngarkesat e automjeteve 13
5 Konsiderata per furnizimi me uje, kanalizimet e ujerave te Ndotura, te shiut dhe mbetjet e ngurta **15**
5.1 Sistemi i furnizimit me ujë (FUP) 15
5.2 Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN) 15
5.3 Sistemi i kanalizimeve te ujerave te shiut (KUSH) 15
5.4 Sistemi i mbetjeve te ngurta Urbane 15
6 Infrastruktura inxhinierike elektrike dhe sistemi i ndriçimit **17**
6.1 Rrjeti inxhinierik i infrastrukturës TM, TU, IT dhe ndriçimit 17
6.1.1 Të përgjithshme 17
6.1.2 Kodet dhe Standardet 17
6.1.3 Sistemi i Ndriçimit 18
Referencat **19**

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1: Lista e kërkesave për institucionet 3
Tabela 4-1: Ngarkesa e automjeteve sipas EN 1991 13

LISTA E FIGURAVE

Figura 4-1: Gjendja e shtresave rrugore e mire..... 7
Figura 4-2: Përroi i Agait dhe sistemi ujore qe shkarkojnë ne te..... 8
Figura 4-3: Foto nga gjurma e segmentit 5 – 6..... 9
Figura 4-4: Skema e ndarjes se ujerave ne segmentin 5 – 6..... 9
Figura 4-5: sistemi i kanalit 3-5-13/1 10
Figura 4-6: Tërthori tip për kanalin 3-5-13/1..... 10
Figura 4-7: Foto nga gjurma e segmentit 9 – 10..... 11
Figura 4-8: Foto nga gjurma ekzistuese e segmentit 1/9 – 5/4 11

1 HYRJE

Zona bregdetare nga Plepat në Golem e deri në Qerret është një zonë tepër tërheqëse përsa i përket turizmit. Ajo është shumë e frekuentuar nga turistët vendas dhe të huaj sidomos gjatë periudhës së verës. Para viteve '90 zona në fjalë ka qenë e pyllëzuar dhe e shumë pak e prekur nga ndërtimet. Më pas, sidomos gjatë dy dekadave të fundit kjo zonë është urbanizuar dhe vazhdon të urbanizohet në mënyrë intensive. Gjatë fazës së urbanizimit vëmendja kryesore ka qenë përqendruar në ndërtimin e objekteve rezidenciale, duke mos u kushtuar vëmendjen e duhur rrjeteve infrastrukturore inxhinierike dhe sidomos drenazhimit. Kjo ka sjellë probleme në kullimin e ujërave sipërfaqësore në zonë. Megjithatë potenciali i zhvillimit të turizmit i kësaj zone bregdetare mbetet shumë i lartë. Për ketë arsye Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka kryer një studim fizibiliteti përsa i përket përmirësimit të infrastrukturës së kësaj zone.

Shoqëria "Illyrian Consulting Engineers" sh.p.k. në cilësinë e Konsulentit ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kontratën me objekt: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë".

Objektivat kryesorë të këtij projekti do të jenë: Përmirësimi i aksesit drejt potencialeve turistike të zonës, me qëllim zhvillimin e turizmit, rritja e cilësisë së jetës për komunitetin dhe pushuesit, rritja e mundësive për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të zonës turistike, përmirësimi dhe siguria e lëvizjes së mjeteve dhe njerëzve brenda zonës turistike si dhe përmirësimi dhe lehtësimi i qarkullimit të mjeteve të transportit nga zona turistike në drejtim të Kavajës, të Durrësit dhe të Tiranës.

Për të arritur objektivat e mësipërm, referuar Termave të Referencës Konsulenti do të trajtojë rreth 26 km rrugë, kanale ose shëtitore, kryesisht në gjurmë ekzistuese. Gjithashtu do të parashikohet një kryqëzim në disnivel (me nënkalim ose mbikalim), i cili do të vendoset midis rrethrotullimit të plepave dhe Malit të Robit dhe duhet të lidhë rrugët dytësore me njëra tjetrën.

Në zonat me intensitet të lartë ndërtimi, do të bëhet planifikimi i hapësirave për parkime, parqe, sheshe etj.

Vendndodhja e projektit jepet ne figurën e mëposhtme dhe kufizohet:

Në Veri: me kufirin ndarës të Njësisë Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, pranë Shkëmbit të Kavajës.

Në Lindje: me superstradën Durrës-Rrogozhinë;

Në Perëndim: me vijën bregdetare;

Në Jug: me Përroin e Lishatit, Qerret, Nj. Administrimi Golem, bashkia Kavajë.

Pjesë e këtij projekti konsiderohet edhe segmenti i rrugës dytësore Rrethrotullimi Plepa-Rrethrotullimi Mali i Robit i emërtuar më poshtë si segmenti 0-1-2, si dhe segmenti i rrugës dytësore Rrethrotullimi Plepa–Nënkalimi Golem i emërtuar më poshtë si segmenti 0-4-3.

Pas diskutimeve me autoritetin kontraktues ne fazën e parë do të ndërtohen akset e mëposhtme:

Segmenti 1/3 – 3. Rruga bashkë me rehabilitimin e përroit të Agait. (0.4 km)

Segmenti 5 – 6 (1.6 km)

Segmenti 9 – 10 (0.6 km)

Segmenti 3 -5 – 13/1 (0.6 km) Kanal kullues

Segmenti 1/5 – 5/9 (0.3 km)

Segmenti 1/9 – 5/4 (0.3 km)

Figura 1-1: Vendndodhja e objektit sipas Termave të Referencës.

2 KORESPONDENCA

Për nevoja të këtij projekti konsulenti ka përgatitur kërkesat për informacion drejtuar institucioneve të cilat ofrojnë shërbim në këtë zonë ose janë pronarë të objekteve nën gjurmën e rrugëve apo kanaleve që do të zhvillohen. Më poshtë jepet lista e Institucioneve të cilave u janë drejtuar kërkesat.

Tabela 2-1: Lista e kërkesave për institucionet

NR RENDOR	LËNDA	EMRI I MARRËSIT	DATA E SHKRESËS	NR I PROTOKOLLIT TË SHKRESËS
11.358	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit të PPV dhe PDV të Zonës në lidhje me projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)	17.08.2020	287-1D
11.339	Kërkesë për vënie në dispozicion të projekteve në zhvillim të zonës ku shtrihet projekti: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Autoriteti Rrugor Shqiptar	17.08.2020	287-1D
11.340	Kërkesë për vënie në dispozicion të projekteve në zhvillim të zonës ku shtrihet projekti: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë	Hekurudha Shqiptare	17.08.2020	287-1D
11.341	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Bashkisë Durrës	17.08.2020	287-1D
11.342	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Bashkisë Kavajë	17.08.2020	287-1D
11.343	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.	17.08.2020	287-1D
11.344	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Operatori i Sistemit të Transmetimit	17.08.2020	287-1D
11.345	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a (UKD)	17.08.2020	287-1D
11.346	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Ujësjellës Kanalizime Kavajë sh.a (UKK)	17.08.2020	287-1D
11.347	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime dhe Mbetjeve te Ngurta (AKUM)	17.08.2020	287-1D
11.348	Kërkesë për informacion në lidhje me projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Institutit të Monumenteve të Kulturës	17.08.2020	287-1D
11.349	Kërkesë mbi të dhënat për reshje maksimale vjetore me kohëzgjatje 10 min, 20 min, 30 min, 60 min, 2 ore, 6 ore, 12 ore dhe 24 ore për stacionet hidrometrike dhe meteorologjike për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)	17.08.2020	287-1D

NR RENDOR	LËNDA	EMRI I MARRËSIT	DATA E SHKRESËS	NR I PROTOKOLLIT TË SHKRESËS
11.350	Kërkesë për vënie në dispozicion të projekteve në zhvillim të zonës ku shtrihet projekti: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit	17.08.2020	287-1D
11.351	Kërkesë për informacion në lidhje me projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Ministrisë së Mbrojtjes	17.08.2020	287-1D
11.352	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Albanian Broadband Communication sh.p.k.	17.08.2020	287-1D
11.353	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Abissnet	17.08.2020	287-1D
11.354	Kërkesë për informacion në lidhje me projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)	17.08.2020	287-1D
11.355	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Albtelecom Sh.a.	17.08.2020	287-1D
11.356	Kërkesë për informacion në lidhje me projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA)	17.08.2020	287-1D
11.357	Kërkesë për azhurnim rrjetesh dhe planesh zhvillimi për projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Digicom	17.08.2020	287-1D
11.358	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit të PPV dhe PDV të Zonës në lidhje me projektin: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë"	Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit	17.08.2020	287-1D
11.359	Kerkese per venie ne dispozicion te projekteve te zones ku shtrihet projekti " Studim Projektim I zones turistike "Golem Kavaje"	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	17.08.2020	287-1D

Nga institucionet e lartpërmendura janë marrë përgjigje dhe janë kryer takime me disa prej tyre. Konkretisht janë kthyer përgjigje nga këto institucione:

NR.	EMRI I MARRËSIT	DATA E SHKRESËS	KTHIM PËRGJIGJE
1	Hekurudha Shqiptare	17.08.2020	25.08.2020 √
2	Bashkisë Durrës	17.08.2020	20.08.2020 √
3	Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a (UKD)	17.08.2020	28.08.2020 √
4	Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime dhe Mbetjeve te Ngurta (AKUM)	17.08.2020	25.08.2020 √
5	Institutit të Monumenteve të Kulturës	17.08.2020	21.08.2020 √
6	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)	17.08.2020	03.09.2020 √
7	Albtelecom Sh.a.	17.08.2020	25.08.2020 √
8	Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit	17.08.2020	27.08.2020 √
9	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	17.08.2020	27.08.2020 √

Bashkia Kavajë, si një nga institucionet që ndikohet më shumë nga ky investim, ka kërkuar projektet e propozuara që ti shqyrtojë me konsulentin në detaje. Për këtë arsye më dt. 21.08.2020 u zhvillua një vizitë në terren. Më dt. 31.08.2020 u organizua një takim në zyrën e urbanistikes së Bashkisë Kavajë.

Në këtë mbledhje u diskutuan gjetjet në terren, problematikat, mundësitë për rrugë të reja dhe përshtatja e zgjidhjeve me planin e përgjithshëm. Gjithashtu u diskutuan edhe problematikat e kanalizimeve të ujerave të ndotura dhe ujërave te shiut të cilat janë ne problematike thelbësore e zonës.

Të gjitha diskutimet si dhe kthim përgjigjet e marra nga letërkëmbimet janë reflektuar ne fazën e deritanishme.

3 KRITERET E PROJEKTIMIT

3.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike

- Projektimi i rrugëve do të bëhet në përputhje me "Rregullin Teknik për Projektimin e Rrugëve" të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 628, datë 15.7.2015.
- Projektimi gjeometrik i rrugëve do të kryhet në përputhje me "Rregullin teknik për projektimin e rrugëve (RrTPRr-2) – Projektimi gjeometrik"
- Projektimi i shtresave rrugore do të kryhet në përputhje me "Rregullin teknik për projektimin e rrugëve (RrTPRr-3) – Projektimi i dyshemesë" dhe "AASHTO (Guide for Design of Pavements Structures 1993)"
- Projektimi i sinjalistikës rrugore do të kryhet në përputhje me "Rregullin teknik për projektimin e rrugëve (RrTPRr-6) – Sinjalistika rrugore" dhe në përputhje me "Kodin Rrugor" në fuqi dhe Rregulloren e Zbatimit të tij.
- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor.
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet në struktura.
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave të betonit.
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku.
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik.
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave për rezistencë nga tërmeti
- KTP 2-78 Kushtet Teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-89 Kushtet Teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (Norma Teknike për projektimin.

3.2 Parametrat e projektimit

Rrugët e shërbimit të rrugës ndërurbane Durrës – Rrogozhinë dhe kryqëzimit në disnivel:

Shpejtësia e Projektimit:	50 km/h
Pjerrësia gjatësore maksimale:	10 %
Pjerrësia gjatësore minimale për drenazhim:	0.5 %
Pjerrësia tërthore:	2.5%
Mbilartësimi maksimal:	7%
Periudha e Projektimit:	20 vjet

Rrugët urbane të Golemit:

Shpejtësia e Projektimit:	30 km/h
Pjerrësia gjatësore maksimale:	8 %
Pjerrësia gjatësore minimale për drenazhim:	0.3 %
Pjerrësia tërthore:	2.5%
Periudha e Projektimit:	20 vjet

4 KONSIDERATAT PËR PROJEKTIMIN E RRUGËS

4.1 Gjendja ekzistuese

4.1.1 Segmenti 1/3 – 3

4.1.1.1 Rruga

Ky segment ka një gjatësi prej 0.4 km. Rruga është e asfaltuar përgjithësisht në gjendje të mirë.

Figura 4-1: Gjendja e shtresave rrugore e mire.

4.1.1.2 Përroi i Agait

Në anën e djathtë të kësaj rruge kalon përroi i Agait i cili ka një prurje të konsiderueshme. Ne gjendjen ekzistuese ky përrua në pjesën fundore të tij është i mbyllur me kanal te mbyllur 1.6x2 m, të cilët nuk mjaftojnë për përcjelljen e prurjes maksimale të tij.



Figura 4-2: Përroi i Agait dhe sistemi ujore qe shkarkojnë ne te.

Nga pikëpamja e tërësisë ujore ky përrua është shumë i rëndësishëm sepse ai mbledh të gjitha ujërat në bjefin e sipërm mbi hekurudhë dhe nën hekurudhë. Pra ky përrua duhet te disiplinohet dhe ti nënshtrohet një trajtimi të veçantë për një zgjidhje përfundimtare duke mos cenuar prishjen e ekuilibrave ujore dhe mjedisore ne zonë. Nisur nga efektet sociale dhe mjedisore që mund te sjellë kthimi në identitet i këtij përroi janë vlerësuar dhe propozuar nga konsulenti disa variante:

4.1.2 Segmenti 5 – 6

Ky segment ka një gjatësi prej 1.6 km. Ky segment, i parashikuar edhe në planin urbanistik të zonës do të jetë një nga akset me kryesore të Golemit pas ndërtimit të tij. Pjesa më e madhe do të jetë rrugë krejtësisht e re.

Figura 4-3: Foto nga gjurma e segmentit 5 – 6.

Ky segment do të shërbejë gjithashtu si një nga kolektorët kryesore të drenazhimit të zonës. Po ashtu në të do të shtohen edhe rrjetet e tjera inxhinierike. Si rrjedhim ka një peshë të rëndësishme përsa i përket kostos së projektit. Imazhi i mëposhtëm tregon skemën e ndarjeve të ujërave të zonës si dhe efluentet kryesorë që shkarkohen në këtë aks.



Figura 4-4: Skema e ndarjes se ujerave ne segmentin 5 – 6

Siç shikohet edhe në këtë skemë është shumë e dukshme që në 1.6 km hapësirë nuk ka asnjë shkarkim në drejtim te bregdetit. Ato ndahen vetëm në dy shkarkimet anësore, 1 përroi i Agait dhe 2 dalja në rrethrrotullimin e Golemit. Gjithashtu në këtë segment shkarkojnë edhe disa nga rrjedhat ujore që vijnë nga rruga nacionale të cilat kanë një prurje të konsiderueshme. Këto rrjedha nuk shkarkojnë në det aktualisht dhe duhet te orientohen. Nga topografia rezulton se kuotat në mesin e këtij segmenti janë shumë të ulëta dhe nuk janë në favor për të bere seksione hidraulike ekonomike. Në këtë situatë ujërat duhet të disiplinohen me kanale betoni 2x1.5, 2x2, 3x2, 4x2, 6x2.5 përkatësisht sipas prurjeve të tyre.

4.1.3 Segmenti 3 – 5 – 13/1 (kanal-Nënkalimi Golemit)

Ky segment është pjesë e rrugëve ekzistuese dhe do ti nënshtrohet vetëm ndërhyrjes për ndërtimin e kanalit të shkarkimeve të ujerave të shiut. Në terren është pjesërisht i hapur dhe drenazhon vetëm zonën

lokale. Siç shikohet edhe në skemën më poshtë ku më vijë blu të vazhduar jepet gjurma e kanalit të propozuar dhe me vijë të ndërprerë tregohet zgjatimi i tij në drejtim të nënkalimit te Golemit. Kjo shtesë duhet trajtuar sepse nga vizita në terren rezulton së ujërat në piken 3 nuk janë të disiplinuara. Në dalje duhet trajtim i formës se lidhjes me detin, në të kundërt kanali nuk do te funksionojë.



Figura 4-5: sistemi i kanalit 3-5-13/1



Figura 4-6: Tërthori tip për kanalin 3-5-13/1

4.1.4 Segmenti 9 – 10

Ky segment ka një gjatësi prej 0.6 km. Rruga është pjesërisht e asfaltuar, pjesërisht e shtruar me çakëll dhe një pjese tjetër e saj është e pashtruar.

Figura 4-7: Foto nga gjurma e segmentit 9 – 10

4.1.5 Rrugët e tjera lokale

Rrugët lokale të këtij projekti kanë një gjatësi totale prej 7 km. Përgjithësisht janë rrugë të paasfaltuara, por që kalojnë në gjurmë ekzistuese. Më poshtë jepen pamje të gjendjes se këtyre rrugëve.

Figura 4-8: Foto nga gjurma ekzistuese e segmentit 1/9 – 5/4

4.2 Projektimi Gjeometrik

Gjatë projektimit, konsulenti do të tentojë të ruajë sa më shumë që të jetë e mundur shtresat e rrugëve ekzistuese nëse gjendje të mirë.

Gjatë trasimit dhe përcaktimit të vendndodhjes së rrugëve konsulenti do të mbështetet në planin urbanistik të Bashkisë Kavajë dhe Durrës. Të gjithë profilat tërthorë tip të rrugëve do të ndërtohen duke u mbështetur ne atë plan.

Në këtë projekt do të konsiderohen dy kategori rrugësh sipas "Rregullit teknik për projektimin e rrugëve":

1. **E - Rrugë urbane Dytësore**
2. **F - Rrugë urbane Lokale**

4.3 Shtresat rrugore

Periudha për të cilën do të projektohen shtresat rrugore është 20 vjet siç është përmendur në kriteret e projektimit.

Llogaritja e shtresave rrugore do të kryhet sipas "Rregullit teknik për projektimin e rrugëve (RrTPRr-3) – Projektimi i dyshemesë" i cili mbështet në metodologjinë së AASHTO për projektimin e rrugëve.

Udhëzuesi i projektimit AASHTO bazohet në konceptin e ngarkesës së përgjithshme të trafikut në terma të një ngarkese statike të vetme e njohur si ngarkesë një aksiale ekuivalente 80 kN (ESAL).

Pas vlerësimit që i është bërë trafikut duke marrë parasysh zonën që do të zhvillohet si dhe rrugët fqinje për llogaritjen e shtresave rrugore është konsideruar një trafik mesatar ditor prej **5000 mjetesh/dite** për segmentet 5 – 6, 9 –10 dhe 1/3 – 3. Kurse për rrugët lokale është konsideruar një trafik mesatar ditor prej **1000 mjetesh/dite.**

Për periudhën e zgjedhur të projektimit trafiku i parashikuar llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$\widehat{W}_{80} = W_{80}^{1} \cdot \left[\frac{(1+g)^t - 1}{g}\right]$$

Ku :

$W^{\wedge}_{80}$= ngarkesat totale në të dy-drejtimet e parashikuar për një seksion specifik rruge gjatë periudhës së projektimit.

W^{1}_{80} = ngarkesat totale në të dy-drejtimet e matur për një seksion specifik rruge gjatë periudhës së vënies në shfrytëzim.

g = 5% përqindje e rritjes së trafikut në vit.

t = 20 vjet Periudha kohore e projektimit

Pas llogaritjeve paketa bazë e shtresave rrugore do të jetë:

Segmenti 5 – 6, 9 –10 dhe 1/3 – 3:

Asfalti	4 cm
Binderi	6 cm
Stabilizant	20 cm
Çakëll	40 cm
Zhavorr	20 cm
Total	**90 cm**

Rrugët lokale:

Asfalti	4 cm

Binderi	6 cm
Stabilizant	20 cm
Çakëll	30 cm
Total	**60 cm**

4.4 Konsiderata për projektimin strukturor

Projektimi i strukturave do të bëhet në përputhje me Rregullat Teknikë të Projektimit Rrugëve (RrTPRr-5_ - Urat dhe Tunelet si dhe normat Evropiane (Eurokodet).

4.4.1 Ngarkesat e automjeteve

Për përcaktimin e efekteve të ngarkesës së trafikut, merren në konsideratë ngarkesat karakteristike të lidhura me verifikimin sipas gjendjes së fundit kufitare (ULS) dhe në raste të veçanta me gjendjen e shërbimshmërisë (sipas EN 1990 deri në EN 1999).

Vlerat karakteristike të ngarkesave të përqendruara dhe të shpërndara të trafikut sipas LM1, jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4-1: Ngarkesa e automjeteve sipas EN 1991

Pozicioni	**Ngarkesa e Përqendruar për makina me 2 akse**	**Ngarkesa Njëtrajtësisht e Shpërndarë**
	Ngarkesa aksiale Q_{ik} (kN)	**q_{ik} (kN/m^2)**
Korsia Nr.1	300	9
Korsia Nr.2	200	2,5
Korsia Nr.3	100	2,5
Korsi të tjera	0	2,5
Zona e mbetur (q_{rk})	0	2,5

Detajet e modelit të ngarkimit 1 jepen në figurën e mëposhtme:



***) Për w_l = 3,00 m**

Figura 4-1: Detaje të modelit të ngarkimit 1 (LM1) për ngarkesat e trafikut

Vlerat e ngarkesave aksiale nënkuptojnë që të kemi dy rrota identike me ngarkesë $0,5\alpha_Q Q_k$ secila. Vlerat e faktorëve korrigjues α_{Qi}, α_{qi} dhe α_{qr} do të merren të barabartë me njësinë ($\alpha = 1$). Sipërfaqja e kontaktit të secilës gomë do të merret (0,4x0,4) m.

5 KONSIDERATA PER FURNIZIMI ME UJE, KANALIZIMET E UJERAVE TE NDOTURA, TE SHIUT DHE MBETJET E NGURTA

5.1 Sistemi i furnizimit me ujë (FUP)

Zona ne studim nga vizita në terren vërehet një mungese e infrastrukturës së këtij sistemi, gjithashtu kjo gjë konfirmohet edhe nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës se Mbetjeve. E cila ka miratuar pak kohe me pare edhe projekte për furnizimin me ujë te kësaj zone. Ky projekt duhet ti vihet në dispozicion projektuesit ne mënyre qe te unifikohen te gjitha linjat inxhinierike pa krijuar konflikte ndërmjet linjave ekzistuese dhe te reja. Gjithashtu konsulenti do te beje te gjitha kontrollet dhe ndërhyrjet e duhura qe linjat me vete rrjedhje te jene te unifikuar dhe te mos krijohen konflikte me sistemin e ri.

5.2 Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN)

Sistemi i shkarkimeve te ujerave te ndotura është ekzistues dhe me sistem me gravitet ne drejtim te stacioneve t pompave dhe ato ndahen pjesërisht ne drejtime te stacionit te trajtimit te ujerave te ndotura te Kavajës. Për këtë kërkohet me shume informacion nga bashkia Kavajë.

Problematika ne terren vërehet ne pikat e lidhjeve te këtij sistemi (atij kryesor) me ate sekondar. Pusetat janë të ndryshme dhe te dëmtuara dhe futen ujerat e shiut. Stacionet e pompave nuk punojnë.

Pas mbledhjes se informacionit nga institucionet përgjegjëse dhe rilevimi ne terren do te gjykohet mbi shkallen e ndërhyrjeve ne sistemin ekzistues.

5.3 Sistemi i kanalizimeve te ujerave te shiut (KUSH)

Sistemi i ujerave te shiut, siç është përshkruar edhe me sipër, pothuajse mungon. Ne ato raste kur është ndërtuar sistemi i drenazhimit, ai është në gjendje kaotike dhe i pa orientuar, shpërndahet ne drejtime të ndryshme nëpër rruge dhe sipërfaqe të pa shtruara. Kanalet janë pothuajse te mbushura gjithmonë me ujë dhe barishte te pa pastruara. Kanalet kryesor që zbresin nga rruga kryesore në drejtim te bregut te detit janë bllokuar ose zvogëluar shume, madje ne disa raste mbi to janë ndërtuar rruge.

5.4 Sistemi i mbetjeve te ngurta Urbane

Nga vizita ne terren janë vërejtur një gjendje shume e çrregullt e vendosjeve te koshave për mbledhjen e mbeturinave. Situata e gjendjes aktual jepet qarte edhe ne fotot e mëposhtme.



6 INFRASTRUKTURA INXHINIERIKE ELEKTRIKE DHE SISTEMI I NDRIÇIMIT

6.1 Rrjeti inxhinierik i infrastrukturës TM, TU, IT dhe ndriçimit

6.1.1 Të përgjithshme

Projektimi i infrastrukturës inxhinierike elektrike dhe IT konsiston në marrjen në konsideratë nga ana e projektuesit të disa pikave kryesore të cilat janë:

- Gjendja ekzistuese e kabinave, linjave elektrike dhe IT.
- Sigurinë dhe kushtet teknike të projektimit.
- Spostimin e Kabinave Elektrike ekzistuese për shkak të gjurmës së projektit.
- Spostimin e Shtyllave Elektrike ekzistuese TU, TM, TL për shkak të gjurmës së projektit.
- Demontim të Shtyllave ekzistuese Elektrike TU, TM, TL dhe IT të cilat janë të amortizuara ose janë jashtë funksionit, që preken nga gjurma e projektit.
- Demontim të linjave dhe kabujve ekzistues të cilat janë jashtë funksionit.
- Ndriçimi i kryqëzimeve, rrugëve, trotuareve, shëtitoreve etj.
- Spostim/Infrastrukturë nëntokësore të linjave IT.

Spostimi i linjave elektrike TM dhe TU do të bëhet duke respektuar të gjitha kushtet teknike në fuqi dhe standartet e OSHEE.

Në lidhje me infrastrukturën nëntokësore do të përdoren puseta me dimensione të brendshme 50x50x55 cm. Bateria e këtyre pusetave do të përbëhet nga tuba 4xØ75mm, në të cilat 2 tuba Ø75mm do jenë për furnizimin me energji elektrike të ndriçimit rrugor, dhe 2 tuba Ø75mm për fibrat optike. Të gjitha pusetat do të jenë të armuara dhe kapaku i tyre do të jetë sipas standartit EN124.

Duke u bazuar në vendimin e ERE Nr. 166 dt. 10/10/2016 del e nevojshme që shpenzimet për spostimin e kabinave 20/0.4 kV si dhe pjesës së fiderit 20 kV që ndodhen në gjurmën e projektit, duhet të planifikohen në preventivin e këtij projekti, dhe duhet të bëhen nga ana e Investitorit, si dhe të gjitha punimet duhet të bëhen nën mbikëqyrjen dhe asistencën teknike të OSHEE. Në lidhje me linjat TU ajrore të cilat do të spostohen, ose elementë të këtyre linjave të cilat janë të amortizuara ose jashtë funksionit të cilat do të demontohen, është e nevojshme që në planin e investimit të merret parasysh edhe demontimi i një pjese të rrjetit shpërndarës të TU. Duke u bazuar në vendimin e ERE Nr. 166 dt. 10/10/2016 del e nevojshme që shpenzimet për spostime dhe demontime te rrjetit TU të planifikohen në preventivin e Projektit.

6.1.2 Kodet dhe Standardet

- BS EN 13201-1: Guidelines on selection of lighting classes
- BS EN 12665: Light and lighting - Basic terms and criteria for specifying lighting equirements.
- BS 7430:2011: Code of practice for protective earthing of electrical installations.
- BS EN 60598 2003: Luminaires-Part 2-3- Particular requirements-Luminaires for road and street lighting.
- UNI 11248: Road lighting, selection according to road classification.
- UNI EN 40-5: Standards of road lighting and their application.
- UNI EN 40-2: The rule on the dimensions of the poles and the depth of the fixation on the ground.
- CEI 64-7: Pole positioning according to the environment where it will be installed.

- CEI 64-8: Electrical calculation system, overflow system, protection against direct and indirect contact.
- CEI 20-22: Standard on FG16OR coating cables.
- CEI 11-17: Standard on the highway installation and installation of cable infrastructure.
- CEI 32-01: Standard on the application of security protection in road lighting plants.
- IEC 60439-1: Low voltage panels and assembly of frames.
- IEC 60947: Low-voltage switchboards and their control.
- IEC 60502: Power cables with extruded insulation and their accessories for rated voltage from 1 kV (Um=1,2 kV) up to 30 kV (Um=36kV).
- IEC 227: "PVC insulated cables of rated voltages up to and including 450/750 V".

6.1.3 Sistemi i Ndriçimit

Në lidhje me sistemin e ndriçimit, janë marrë në konsideratë të gjithë parametrat e e rrugës, numrit të banorëve, trafikut të makinave, lëvizjes së këmbësoreve, biçikletave etj. Për të llogaritur vlerat e ndriçimit që nevojiten për ndriçimin e këtyre zonave, është marrë në konsideratë standarti BS EN 13201:2015. Të gjitha modelimet përkatëse[1] janë bërë me programin Dialux. Gjatë modelimit janë marrë në konsideratë :

- Vlera mesatare e fluksit të dritës efektive (Lm)
- Shkalla e uniformitetit të përgjithshëm të dritës (Uo)
- Shkalla e uniformitetit gjatësor të dritës (Ul)
- Koeficienti i verbimit (Ti)

Shtyllat e përdorura për ndriçim do të jenë me gjatësi totale të tyre 9.8 metër dhe 8.8 metër, gjithashtu duhet të jenë sipas specifikimeve teknike.

[1] Për secilën kategori rruge

REFERENCAT

- Detyra e Projektimit, nga Autoriteti kontraktues
- VKM Nr. 628, date 15.07.2015 Për miratimin e Rregullave të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve
- Kushtet teknike të projektimit (Ujësjellësa dhe Kanalizime), 1978
- Standardi Europian BS EN 805, UNI EN 805
- Standardi Europian BS EN 752, UNI EN 752
- Standardi Europian BS EN 12050
- Standardi Europian BS EN 12056
- Standardi Europian BS EN 1610
- Standardi Europian BS EN 124
- Standardi Europian DIN EN 1955, etj
- Acquedotti – Guida alla progettazione, Valerio Milano
- Sistemi di Fognatura – Manuale di Progettazione, grup autorësh
- Pompe e Impianti di sollevamento, Alberto Bianchi, Umberto Sanfilippo

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIA DEVELOPMENT FUND

RIKUALIFIKIM URBAN I ZONËS TURISTIKE, GOLEM - LOT I

Aneksi A – Llogaritjet e Shtresave Rrugore

Shtator, 2020

KONSULENTI: ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS

Porositësi:	**Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
Konsulenti:	**Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.**
Objekti:	**Rikualifikim Urban i Zonës Turistike, Golem - Lot I**
Titulli i Dokumentit:	**Aneksi A – Llogaritjet e Shtresave Rrugore**
Faza e Projektit:	**Projekt Zbatimi**
Kodi i dokumentit:	**ICE-287-P01-V1 03**

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për miratim		08.09.2020

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Vasil Leka	Olset Haxhiu Blenard Durmishi			
Data:	31.08.2020	08.09.2020	08.09.2020		
Statusi i Dokumentit:	**Përfundimtar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**

Tiranë 2020

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja ..... **i**
Lista e Tabelave ..... Error! Bookmark not defined.
Lista e Figurave ..... Error! Bookmark not defined.
1 Projektimi i shtresave rrugore të segmentit 5-6, 9-10 dhe 1/3 -3 ..... **1**
2 PROJEKTIMI I SHTRESAVE RRUGORE TË SEGMENTIT 1/5 - 5/9 dhe 1/9 - 5/4 ..... **4**

1 PROJEKTIMI I SHTRESAVE RRUGORE TË SEGMENTIT 5-6, 9-10 DHE 1/3 -3

TË DHËNA:

1-Traffic:

n=	2	korsi	*Number of lanes per direction*
D_D=	1.00		*Directional distribution factor*
D_L=	1.00		*Lane distribution factor*

Table 1: Shperndarja e Trafikut

Vehicle Class No.	Vehicle Class	Typical ESAL	AADT for eackh vehicle class	Daily ESAL	PCE factor	Passenger car equivalent
1	Motorcycles	0.000015	300	0.00447331	0.5	150
2	Passenger cars	0.001163	4100	4.77	1	4100
3	Pickups, Panels, Vans	0.008352	450	3.76	1	450
4	Buses	0.577291	80	46.18	3.5	280
5	Single Unit 2-Axle Trucks	0.288515	2	0.58	3.5	7
6	Single Unit 3-Axle Trucks	0.492711	2	0.99	3.5	7
7	Single Unit 4 or More-Axle Trucks	0.597833	2	1.20	3.5	7
8	Single Trailer 3- or 4-Axle Trucks	0.331022	1	0.33	3.5	3.5
9	Single Trailer 5-Axle Trucks	1.237570	1	1.24	4	4
10	Single Trailer 6 or More-Axle Trucks	1.381913	1	1.38	3.5	3.5
11	Multi-Trailer 5 or Less-Axle Trucks	0.895650		0.00	3.5	0
12	Multi-Trailer 6-Axle Trucks	1.334809	0	0.00	3.5	0
13	Multi-Trailer 7 or More-Axle Trucks	1.428643	0	0.00	4	0
			Sum	60.4	AADT	5'012
			Yearly ESAL	22'070	**AAT**	1'830'633
			Yearly ESAL / Design lane	22'070		
			Traffic annual growth rate **r**	5%		5%
			Design Life **Y** (years)	20		20

$$\boldsymbol{ESAL\ total} = \mathrm{Y} * \text{Yearly ESAL} * \mathrm{G} = \mathrm{Y} * \text{Yearly ESAL} * \frac{(1+r)^{Y}-1}{r}$$

729'752	**PCE Total**	**60'531'627**

2-Besueshmeria

B=	95.00%	*Besueshmeria*

Z_R=	-1.645	*Shmangia normale standarde*
S_0=	0.5	*Gabimi standard i kombinuar i parashikimit të trafikut dhe funksionimit*

Tabela 2: Vlerat e Rekomanduara të Besueshmërisë (AASHTO, 1993)

Klasifikimi i rrugës	Vlerat e rekomanduara të besueshmërisë	
	Urbane	Rurale
Autostrada	85% - 99.9%	80% - 99.9%
Arterie Kryesore	80% - 99.9%	75% - 95%
Kolektorë	80% - 95%	75% - 95%
Lokale	50% - 80%	50% - 80%

Tabela 3: Shmangia Normale Standarde për Besueshmëri të Ndryshme

Besueshmëria (%)	Shmangia normale standarde	Besueshmëria (%)	Shmangia normale standarde
50	0	93	-1.476
60	-0.253	94	-1.555
70	-0.524	95	-1.645
75	-0.674	96	-1.751
80	-0.841	97	-1.881
85	-1.037	98	-2.054
90	-1.282	99	-2.327
91	-1.34	99.9	-3.09
92	-1.405	99.99	-3.75

3-Treguesi i Shërbyeshmërisë

Shërbyeshmëria është një koncept i lidhur me funksionin kryesor të strukturës së dyshemesë: ti ofrojë publikut udhëtues një drejtim mjeti të lehtë, të rehatshëm dhe të sigurt. Përdoret një shkallë vlerësimi nga 0 në 5 për vlerësimin e treguesit të shërbyeshmërisë aktuale (PSI); shtresa me vlerësimin 0 është e pakalueshme dhe 5 do të ishte e lëmuar në mënyrë perfekte.
Humbja e shërbyeshmërisë së projektimit (ΔPSI) përcaktohet duke zbritur PSI përfundimtare në fund të periudhës së projektimit prej PSI fillestare në fillim të ndërtimit. PSI në fillim të ndërtimit do të jetë normalisht nga 4.2 në 4.6 dhe zakonisht mund të pranohet të jetë 4.5. PSI në fund të periudhës së projektimit është rasti më i keq i kushteve të pranueshme të cilat mund të arrijë shtresa. Një PSI kufitare prej 2.5 është e pranueshme për rrugë me Trafik Mesatar Ditor (ADT) prej 750 ose më shumë.

ΔPSI=	2	*Humbja e shërbyeshmërisë së projektimit*

4-Tabani

CBR=	3	%	*Californian Bearing Ratio*
M_R=	**4500**	psi	*Subgrade resilient modulus (psi) M_R=1500*CBR (%) acc. AASHTO 1993* *Subgrade resilient modulus (psi) M_R=2055*[CBR(%)]$^{0.64}$ acc. AASHTO 2002 Design Guide*
M_R=	**31026.408**	kPa	*Subgrade resilient modulus (kPa)*

5-Llogaritja e Numrit Strukturor

Llogaritja e SN behet nga ekuacioni i meposhtem:

$$\log_{10} W_{18} = z_R \cdot S_0 + 9.36 \cdot \log_{10}(SN+1) - 20 + \frac{\log_{10}\left(\frac{\Delta PSI}{4.2-1.5}\right)}{0.40 + \frac{1094}{(SN+1)^{5.19}}} + 2.32 \cdot \log_{10} M_R - 8.07$$

	0.0000000	
SN=	**4.19**	in
SN=	**10.64**	cm

Solver Parameters	
	FALSE
	1
	100
	100

6-Përcaktimi i paketës së shtresave

Koeficienti i shtresës shpreh marrëdhënien empirike midis SN dhe trashësisë, dhe është një masë e aftësisë relative të materialit për të funksionuar si një komponent strukturor i dyshemesë.

$$SN = a_1 \cdot D_1 + a_2 \cdot D_2 \cdot m_2 + a_3 \cdot D_3 \cdot m_3 + \cdots + a_n \cdot D_n \cdot m_n$$

Tabela 4: Koeficientët dhe Trashësitë e Shtresave

Nr.	Emri i Shtreses	Koeficenti i shtreses a_i	Koeficenti i drenimit m_i	Trashesia e shtreses D (cm)	$a_i*d_i*m_i$ (cm)
1	Asfalt	0.44	1	4	**1.76**
2	Binder	0.4	1	6	**2.4**
3	Konglomerat	0.3	1	0	**0**
4	Stabilizant	0.14	0.8	20	**2.24**
5	Cakull	0.11	0.8	40	**3.52**
6	Zhavorr	0.1	0.8	20	**1.6**
7					**0**
8					**0**
9					**0**
10					**0**
			Total	**90**	**11.52**

Trashesia e Shtresave OK

2 PROJEKTIMI I SHTRESAVE RRUGORE TË SEGMENTIT 1/5 - 5/9 DHE 1/9 - 5/4

TË DHËNA:

1-Traffic:

n=	2	korsi	*Number of lanes per direction*
D_D=	1.00		*Directional distribution factor*
D_L=	1.00		*Lane distribution factor*

Table 1: Shperndarja e Trafikut

Vehicle Class No.	Vehicle Class	Typical ESAL	AADT for eackh vehicle class	Daily ESAL	PCE factor	Passenger car equivalent
1	Motorcycles	0.000015	300	0.00447331	0.5	150
2	Passenger cars	0.001163	350	0.41	1	350
3	Pickups, Panels, Vans	0.008352	450	3.76	1	450
4	Buses	0.577291	10	5.77	3.5	35
5	Single Unit 2-Axle Trucks	0.288515	2	0.58	3.5	7
6	Single Unit 3-Axle Trucks	0.492711	2	0.99	3.5	7
7	Single Unit 4 or More-Axle Trucks	0.597833		0.00	3.5	0
8	Single Trailer 3- or 4-Axle Trucks	0.331022		0.00	3.5	0
9	Single Trailer 5-Axle Trucks	1.237570		0.00	4	0
10	Single Trailer 6 or More-Axle Trucks	1.381913		0.00	3.5	0
11	Multi-Trailer 5 or Less-Axle Trucks	0.895650		0.00	3.5	0
12	Multi-Trailer 6-Axle Trucks	1.334809	0	0.00	3.5	0
13	Multi-Trailer 7 or More-Axle Trucks	1.428643	0	0.00	4	0
			Sum	11.5	AADT	999
			Yearly ESAL	4'202	**AAT**	364'885
			Yearly ESAL / Design lane	4'202		
			Traffic annual growth rate **r**	5%		5%
			Design Life **Y** (years)	20		20

$$\boldsymbol{ESAL\ total} = \mathrm{Y} * \text{Yearly ESAL} * \mathrm{G} = \mathrm{Y} * \text{Yearly ESAL} * \frac{(1+r)^{Y}-1}{r}$$

138'954	**PCE Total**	**12'065'262**

2-Besueshmeria

B=	95.00%	*Besueshmeria*

Z_R=	-1.645	*Shmangia normale standarde*
S_0=	0.5	*Gabimi standard i kombinuar i parashikimit të trafikut dhe funksionimit*

Tabela 2: Vlerat e Rekomanduara të Besueshmërisë (AASHTO, 1993)

Klasifikimi i rrugës	Vlerat e rekomanduara të besueshmërisë	
	Urbane	Rurale
Autostrada	85% - 99.9%	80% - 99.9%
Arterie Kryesore	80% - 99.9%	75% - 95%
Kolektorë	80% - 95%	75% - 95%
Lokale	50% - 80%	50% - 80%

Tabela 3: Shmangia Normale Standarde për Besueshmëri të Ndryshme

Besueshmëria (%)	Shmangia normale standarde	Besueshmëria (%)	Shmangia normale standarde
50	0	93	-1.476
60	-0.253	94	-1.555
70	-0.524	95	-1.645
75	-0.674	96	-1.751
80	-0.841	97	-1.881
85	-1.037	98	-2.054
90	-1.282	99	-2.327
91	-1.34	99.9	-3.09
92	-1.405	99.99	-3.75

3-Treguesi i Shërbyeshmërisë

Shërbyeshmëria është një koncept i lidhur me funksionin kryesor të strukturës së dyshemesë: ti ofrojë publikut udhëtues një drejtim mjeti të lehtë, të rehatshëm dhe të sigurt. Përdoret një shkallë vlerësimi nga 0 në 5 për vlerësimin e treguesit të shërbyeshmërisë aktuale (PSI); shtresa me vlerësimin 0 është e pakalueshme dhe 5 do të ishte e lëmuar në mënyrë perfekte.
Humbja e shërbyeshmërisë së projektimit (ΔPSI) përcaktohet duke zbritur PSI përfundimtare në fund të periudhës së projektimit prej PSI fillestare në fillim të ndërtimit. PSI në fillim të ndërtimit do të jetë normalisht nga 4.2 në 4.6 dhe zakonisht mund të pranohet të jetë 4.5. PSI në fund të periudhës së projektimit është rasti më i keq i kushteve të pranueshme të cilat mund të arrijë shtresa. Një PSI kufitare prej 2.5 është e pranueshme për rrugë me Trafik Mesatar Ditor (ADT) prej 750 ose më shumë.

ΔPSI=	2	*Humbja e shërbyeshmërisë së projektimit*

4-Tabani

CBR=	3	%	*Californian Bearing Ratio*
M_R=	**4500**	psi	*Subgrade resilient modulus (psi) M_R=1500*CBR (%) acc. AASHTO 1993* *Subgrade resilient modulus (psi) M_R=2055*[CBR(%)]$^{0.64}$ acc. AASHTO 2002 Design Guide*
M_R=	**31026.408**	kPa	*Subgrade resilient modulus (kPa)*

5-Llogaritja e Numrit Strukturor

Llogaritja e SN behet nga ekuacioni i meposhtem:

$$\log_{10} W_{18} = z_R \cdot S_0 + 9.36 \cdot \log_{10}(SN+1) - 20 + \frac{\log_{10}\left(\frac{\Delta PSI}{4.2-1.5}\right)}{0.40 + \frac{1094}{(SN+1)^{5.19}}} + 2.32 \cdot \log_{10} M_R - 8.07$$

	0.0000002	
SN=	**3.26**	in
SN=	**8.28**	cm

Solver Parameters	
	FALSE
	1
	100
	100

6-Përcaktimi i paketës së shtresave

Koeficienti i shtresës shpreh marrëdhënien empirike midis SN dhe trashësisë, dhe është një masë e aftësisë relative të materialit për të funksionuar si një komponent strukturor i dyshemesë.

$$SN = a_1 \cdot D_1 + a_2 \cdot D_2 \cdot m_2 + a_3 \cdot D_3 \cdot m_3 + \cdots + a_n \cdot D_n \cdot m_n$$

Tabela 4: Koeficientët dhe Trashësitë e Shtresave

Nr.	Emri i Shtreses	Koeficenti i shtreses a_i	Koeficenti i drenimit m_i	Trashesia e shtreses D (cm)	a_i*d_i*m_i (cm)
1	Asfalt	0.44	1	4	1.76
2	Binder	0.4	1	6	2.4
3	Konglomerat	0.3	1	0	0
4	Stabilizant	0.14	0.8	20	2.24
5	Cakull	0.11	0.8	30	2.64
6	Zhavorr	0.1	0.8	0	0
7					0
8					0
9					0
10					0
			Total	**60**	**9.04**

Trashesia e Shtresave OK

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIA DEVELOPMENT FUND

RIKUALIFIKIM URBAN I ZONËS TURISTIKE, GOLEM - LOT I

Aneksi B – Llogaritjet Hidraulike

Shtator, 2020

KONSULENTI: ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS

Porositësi:	**Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
Konsulenti:	**Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.**
Objekti:	**Rikualifikim Urban i Zonës Turistike, Golem - Lot I**
Titulli i Dokumentit:	**Aneksi B – Llogaritjet Hidraulike**
Faza e Projektit:	**Projekt Zbatimi**
Kodi i dokumentit:	**ICE-287-P01-V1 03**

Rish.	**Qëllimi i Dorëzimit**	**Shënime**	**Data**
00	Për miratim		26.09.2020

	KONSULENTI			**POROSITËSI**	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Alban Doko Dritan Bratko	Olset Haxhiu Blenard Durmishi			
Data:	23.08.2020	25.09.2020	25.09.2020		
Statusi i Dokumentit:	**Përfundimtar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**

Tiranë 2020

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja ..... **i**
Lista e Tabelave ..... **ii**
Lista e Figurave ..... **iii**
1 Dimensionimi i Seksionit Tërthor të Përroit të Agait **1**
1.1 Metodologjia e Analizës Hidraulike 1
1.1.1 Përshkrimi i Përgjithshëm 1
1.1.2 Gjeometria 2
1.1.3 Ashpërsia Manning 3
1.1.4 Kushtet Fillestare 3
1.1.5 Prurja Llogaritëse 3
1.2 Rezultatet e Mara nga Simulimi 3
2 Sistemi i Drenazhimit të Ujërave të Shiut **6**
2.1 Kodet dhe Standartet 6
2.2 Kriteret e Projektimit 6
2.3 Përcaktimi i Prurjes 6
2.4 Përcaktimi i Sipërfaqeve 7
2.5 Koha e Bashkëardhjes 7
2.6 Intensiteti i Shiut 8
2.7 Dimensionimi i Sistemeve të Drenazhimit 8
Aneksi A Pellgjet Ujembledhese **9**
Ankesi B Tabela Permbledhese me LLogaritjet e Prurjeve **1**

LISTA E TABELAVE

Tabela 1-1 Rezultatet e Mara nga Modelimi 5
Tabela 2-1 k Faktori i Korrigjimit 7

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1 Pamje nga Gjëndja Ekzistuese e Përroit të Agait 1
Figura 1-2 Planimetria e Modelit të Përroit të Agait në Segmentin që do të Rehabilitohet 2
Figura 1-3 Seksioni Tërthor Segmenti 1 2
Figura 1-4 Seksioni Tërthor Segmenti 2 2
Figura 1-5 Seksioni Tërthor Segmenti 3 3
Figura 1-6 Seksioni Tërthor, Segmenti 1 3
Figura 1-7 Seksioni Tërthor, Segmenti 2 4
Figura 1-8 Seksioni Tërthor, Segmenti 3 4
Figura 1-9 Profili Gjatësor i Përroit 4
Figura 1-10 Pamje 3D e Përroit ne Segmentin e Rehabilituar 5
Figura 2-1 Kurba e Intensiteteve te Shiut (Durrës) 8

1 DIMENSIONIMI I SEKSIONIT TËRTHOR TË PËRROIT TË AGAIT

Për rehabilitimin e Përroit të Agait nga ura e rrugës dytesore paralel me Autostradën Durrës Rrogozhinë, fillimisht është përcaktuar aksi i lumit bazuar në normativat hidraulike si dhe bazuar mbi planin zhvillimor urbanistik të zonës. Shtrati i Përroit të Agait (shih figurën mëposhtë), në fillim (segmenti 1) është i hapur (shtrati i përroit i papastruar dhe plot kallamishte), nga mesi (segmenti i dytë) është i mbyllur dhe përroi kalon në një seksion kuti 2x2m dhe në dalje (segmenti i tretë) është e lire dhe përroit përhapet në plazh.



Figura 1-1 Pamje nga Gjëndja Ekzistuese e Përroit të Agait

Sipas aksit të ri përroi është ndarë në tre segmente:

Sementi 1, është seksion trapezoidal b/a (h=2.8 m, b=6 m, z=1) i hapur me pjerrësi 0.004 m/m,

Segmenti 2, është seksion drejtkëndor b/a (h=2.5 m, b=8.6 m) i mbuluar me pjerrësi 0.004 m/m,

Segmenti 3 është seksion drejtkëndor i hapur (h=1.25 m, b=8.6 m) me mure vertikale palankola të cilat do të shërbejnë pë të rruajtur drejtimin dhe mbrojtjen nga gerryerjet të shtratit të përroit në dalje.

1.1 Metodologjia e Analizës Hidraulike

1.1.1 Përshkrimi i Përgjithshëm

Modeli hidraulik I zhvilluar për kontrollin e seksionit tërthor te rehabilituar te Lumit Lana përfshin segmentin duke filluar mbas urës së rrugës dytësore dhe mbaron aty ku përroi shkarkohet në Detin Adriatik.

Në këtë seksion përshkruhen mënyra e modelimit dhe të dhënat e përdorura për simulimin e rrjedhës llogaritëse si dhe figura ilustruese te modelit.

Softueri HEC - RAS 5.0.7 është përdorur në këtë studim për të simuluar rrjedhën e ujit që kalon në segmentin e rehabilituar të përroit. Për modelimin hidraulik të përroit me anë të softuerit HEC-RAS është përdorur analiza një dimensionale për rrjedha të qëndrueshme.



Figura 1-2 Planimetria e Modelit të Përroit të Agait në Segmentin që do të Rehabilitohet

1.1.2 Gjeometria

E gjithë gjatësia e përroit që do të rehabilitohet përbëhet nga tre tipe seksionesh.

Segmenti 1 me gjatësi reth 175m, pjerrësi 0.004 m/m do të jetë seksion trapezoidal b/a i hapur, me gjerësi b=6m, lartësi h=2.8m dhe pjerrësi të shpateve 1/1.



Figura 1-3 Seksioni Tërthor Segmenti 1

Segmenti 2 me gjatësi reth 300m, pjerrësi 0.004 m/m do të jetë seksion drejtkëndor b/a i mbyllur, me gjerësi b=8.6m dhe lartësi h=2.5m.



Figura 1-4 Seksioni Tërthor Segmenti 2

Segmenti 3 me gjatësi reth 110m do të jetë seksion drejtkëndor me mure vertikale palankola dhe shtrat rëre, gjerësi 8.6m dhe lartësi 1.25 m.



Figura 1-5 Seksioni Tërthor Segmenti 3

1.1.3 Ashpërsia Manning

Ashpërsi n=0.017 për seksionin e betonit, n=0.015 për çelik dhe n=0.020 për rërë.

1.1.4 Kushtet Fillestare

Kushti në hyrje të modelit është pranuar:

- Pjerrësia e Shtratit te Përroit S=0.4%

Kushti në dalje të modelit është pranuar:

- Niveli i detit, niveli i ujit=0 m m.n.d.

1.1.5 Prurja Llogaritëse

Prurja llogaritëse me periudhë përsëritje 1 herë në 50 vjet Q2%=101 m^3/s.

1.2 Rezultatet e Mara nga Simulimi

Mbasi është simuluar rrjedha në HEC-RAS janë mare rezultatet të cilat janë paraqitur në profilin gjatësor dhe në tabelën përmbledhëse më poshtë.



Figura 1-6 Seksioni Tërthor, Segmenti 1



Figura 1-7 Seksioni Tërthor, Segmenti 2



Figura 1-8 Seksioni Tërthor, Segmenti 3



Figura 1-9 Profili Gjatësor i Përroit



Figura 1-10 Pamje 3D e Përroit ne Segmentin e Rehabilituar

Tabela 1-1 Rezultatet e Mara nga Modelimi

Seksioni	Prurja Q2% (m3/s)	Kuota e Bazës (m)	Niveli I Ujit (m)	Shpejtësia (m/s)	Sipërfaqja e Lagur (m²)	Gjerësia në Sipërfaqen e Ujit (m)	Nr. Frudit
6	100	1	3.17	7.26	15.61	9.74	1.63
5	100	0.3	2.47	7.25	15.63	9.74	1.63
4	100	0.26	2.13	7.24	13.92	8.56	1.8
3	100	-0.9	1.05	6.92	14.58	8.57	1.68
2	100	-1	0.6	7.38	14.05	11.02	1.86
1	100	-1	1.04	5.42	21.28	18.53	1.21

2 SISTEMI I DRENAZHIMIT TË UJËRAVE TË SHIUT

2.1 Kodet dhe Standartet

• EN 1610: Ndërtimi dhe testimi i kullimeve dhe kanalizimeve.

• EN 12201 Pjesa 1-4: Polietileni (PE) tuba të përgjithshëm, tuba, pajisje, armatura.

• EN 124: Kapakët e shiut dhe kapakët e pusetave për zona me automjete dhe këmbësorë - kërkesat e projektimit, lloji i testimeve, shënimet, kontrolli i cilësisë.

• EN 752: Sistemi i kullimit dhe kanalizimit jashtë ndërtesave

2.2 Kriteret e Projektimit

Në tabelën e mëposhtme përmblidhen kriteret hidraulike për analizën e sistemit të kanalizimeve dhe të drenazhimit të zonave urbane.

Elementi	**Vlera e Rekomanduar**
Ashpërsia k (HDPE)	0.5 mm
Ashpërsia e Manning-ut Sipërfaqe Betoni	0.018
Thellësia maksimale e lejuar e rrjedhjes	d/D= 75%
Kriteret e shpejtësisë për tubat me gravitet	Minimum: 0.7 m/s Maksimum: 3.0 m/s
Pjerrësia minimale për tubat me gravitet	1/DN
Koha e Bashkëardhjes Minimale	5 min
Siguria e Projektimit të Drenazhimit të ujërave të shiut (qendrat e banuara urbane)	1 herë në 2 vjet
Stacioni Meteorologjik “Durrës Port”	Kurba e Intensitetit të Shiut

Ndërsa përsa i përket sistemit të transportimit të ujërave të shiut të cilat vijnë nga rrjedha të përqendruara si përrenj dhe kanale të ujërave të larta kriteret e projektimit janë marrë sipas kushteve të paraqitura në tabelën mëposhtë.

Elementi	**Vlera e Rekomanduar**
Ashpërsia e Manning-ut Sipërfaqe Betoni	0.018
Kriteret e shpejtësisë	Minimum: 0.7 m/s Maksimum: 6.0 m/s
Siguria e Projektimit të Drenazhimit të ujërave të shiut (qendrat e banuara urbane)	1 herë në 50 vjet
Stacioni Meteorologjik “Durrës Port”	Kurba e Intensitetit të Shiut

2.3 Përcaktimi i Prurjes

Llogaritja e prurjeve maksimale me siguri të ndryshme për akset e veprave të marrjes të HEC-it është bere duke përdorur Metodën Racionale.

Formula Racionale – Për llogaritjen e prurjes maksimale ne përrenjtë ku nuk ka matje te prurjeve, një metode e përdorur gjerësisht për vlerësuar këto prurje është dhe “Formula Racionale”. Aplikimi dhe metoda e funksionimit te kësaj formule jepet me poshtë:

$$Q = 0.00278 \cdot C \cdot I \cdot A$$

Q – Vlera maksimale e prurjes m^3/s

C – Koeficienti i rrjedhës

I – Intensiteti mesatar i shiut për një kohëzgjatje të shiut të barabartë me kohën e përqendrimit, për një periudhë të përzgjedhur kthimi mm/orë

A – Sipërfaqja e pellgut që kontribuon në vendodhjen e projektuar ha

2.4 Përcaktimi i Sipërfaqeve

Për përcaktimin e sipërfaqeve kontribuuese që i korrespondon secilit segment u përdor harta topografike 1/10'000, Ortofoto e 2018 si dhe Raster DEM 2015 i Shqipërisë (https://geoportal.asig.gov.al).

Sipërfaqet Koontribuuese janë paraqitur në viztimi e paraqitur ne Aneksin A.

2.5 Koha e Bashkëardhjes

Sipas formulës Racionale, prurja maksimale gjenerohet nga nje stuhi me kohëzgjatje te njëjtë sa koha e bashkeardhjes tek aski i përzgjedhur. D.m.th. intervali i kohës qe i duhet një pike uji për te udhëtuar nga pika me e larte skajore e pellgut ne piken me te ulet.

Për te llogaritur kohen e bashkeardhjes tc është përdorur ekuacioni sipas Kirpich.

Ekuacioni Kirpich është një formulë empirike e bazuar ne gjatësinë e përroit, pjerrësinë mesatare dhe mbulesën e tokës.

Formula Kirpich është si mposhtë;

$$t_c = k \cdot 0.0195 \left(\frac{L^{0.77}}{S^{0.385}} \right)$$

tc- koha e bashkeardhjes (min)

L- gjatësia e rrjedhës me te gjate (m)

k- faktori i korrigjimit

Tabela 2-1 k Faktori i Korrigjimit

Mbulesa e Tokës	Faktori I korrigjimit te Formulës Kirpich k (Chow et al., 1988; Chin, 2000)
Rrjedha ne sipërfaqe, kanale te veshura me bar	2.0
Rrjedha ne sipërfaqe toke te zhveshur ose kanale rrugore	1.0
Rrjedha ne sipërfaqe betoni ose asfalti	0.4
Rrjedha ne kanale betoni	0.2

S- pjerrësia mesatare e përroit (m/m)

Për qëllimin e llogaritjes se prurjes, pjerrësia e pellgut ujëmbledhës është përcaktuar si pjerrësia përgjatë rrjedhës ujore me te gjate.

H1,H2 – janë kuotat e pikës me te larte dhe me te ulet e rrjedhës (m)

Ne rastin kur kemi sisteme drenazhimi të përbërë nga rrjet tubacionesh ose kanalesh, për të bërë një vlerësim të kohës së bashkëardhjes, shpejtësia e rrjedhjes së ujit në rrjetin e drenazhimit për prurjet maksimale është marrë 1.5 – 2 m/s.

$$t_c = \frac{L}{60V}$$

L- Gjatësia e degës më të gjatë të rrjedhës (m)

V- Shpejtësia e ujit në tuba ose kanale (m/s)

2.6 Intensiteti i Shiut

Për stacionin meteorologjik "Durres" nga të dhënat e marra nga Raporti Hidrologjik për më poshtë është paraqitur kurba intensitet kohëzgjatje frekuencë për periudhën e përsëritjes 1 herë në 2 vjet dhe 1 herë në 50 vjet.



Figura 2-1 Kurba e Intensiteteve te Shiut (Durrës)

2.7 Dimensionimi i Sistemeve të Drenazhimit

Dimensionet i sistemit te drenazhimit me gravitet jane llogaritur me ane te formules Manning:

$$Q = \frac{1}{n} \cdot R_3^2 \cdot s^{0.5}$$

Q- prurja llogaritëse

n – ashpërsia Manning

s- pjerrësia e kanalit/tubacionit

R – rezja hidraulike

Ne tabelën mposhtë jepen për secilin segment dimensionet e llogaritura te sistemit te transportimit te ujërave të shiut.

Table 2-1 Dimensionimi i Sistemit te Drenazhimit

Linjat	Prurja (m3/s)	Pjerresia (m/m)	Ashperisa Manning n	Dimensionet	Thellesia e Ujit (m)	Shpejtesia (m/s)	Lartesia Rezerve (m)
1/5-5/9	1.7	0.0015	0.018	DN 1500 mm	0.93	1.46	0.57
1/7-5/6	2	0.0015	0.018	DN 1500 mm	1.05	1.5	0.45
5/5-5/6	8.8	0.001	0.018	Box 4x1.7 m	1.5	1.57	0.2
5/6-5/7	8.9	0.001	0.018	Box 4x1.7 m	1.51	1.58	0.19
5/7-5/8	9.3	0.001	0.018	Box 4x1.7 m	1.56	1.6	0.14
5/8-5/9	12.1	0.001	0.018	Box 5x1.7 m	1.56	1.69	0.14
5/9-6.	14.9	0.001	0.018	Box 6x1.7 m	1.57	1.75	0.13
5/5-5/4	0.3	0.001	0.018	DN 1000 mm	0.52	0.71	0.58
1/9-5/4	5.4	0.001	0.018	Box 3x1.5 m	1.36	1.4	0.14
5/4-5/2	6	0.001	0.018	Box 3x1.5 m	1.46	1.44	0.04
5/2-5/1	8.7	0.001	0.018	Box 4x1.5 m	1.48	1.57	0.02
5/1-5.	9.8	0.001	0.018	Box 5x1.5 m	1.36	1.6	0.14
3/5.	3.4	0.001	0.018	Box 2x1.5 m	1.42	1.24	0.08
5-10.	11.6	0.001	0.018	Box 6x1.5 m	1.34	1.6	0.16
10-Det	12.8	0.001	0.018	Box 6x1.5 m	1.42	1.67	0.08

ANEKSI A PELLGJET UJEMBLEDHESE

Harta e Pellgjeve Ujembledhese

460000 460500 461000

4570000 4569500 4569000 4568500 4568000

N W E S

1/1 A C 1/3 1/4 D 6 1/5 E 16 6/2 1/6 3/2 1/7 1/8 5/5 5/4 15 6/3 5/3 F 1/10 5/1 10/2 10/1 13/1 10 3 1/11 9/1 13 11/3 11/2

Prr.I Agait

Kan.Zalli i Ukut

Prr.Xhedinit

Prr.Djeri i Gjuzit

Prr.Seferajt

Prr.Zallit

0 0.125 0.25 0.5 Km

Sistemi i Referimit: KRGJSH 2010

ANKESI B TABELA PERMBLEDHESE ME LLOGARITJET E PRURJEVE

Aksi	Segmenti		Siperfaqja (ha)	Gjatesia (m)	Koha e Bashkeardhjes (min)	Stacioni	P24 2vjet mm	n 2vjet	P24 50 vjet mm	n 50vjet	Intensiteti mm/ore (1/2vjet)	Intensiteti mm/ore (1/50 vjet)	Koeficienti I Rrjedhes	Prurja (m3/s) (1/2vjet)	Prurja (m3/s) (1/50vjet)
Perroi I Agait			1736	8122	178	Durres			165.0	0.24		34	0.62		100.7
1/5 - 5/9	1/5 - E	Perroi qe Vjen nga Krahu i Siperm i Hekurudhes	11.03	512	21.0	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	69	171	0.75	1.587639	
1/5 - 5/9	E-5/9	Perroi dhe Zona e Urbanizuar	12.06	606	22.0	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	67	165	0.75	1.673677	
1/7-5/6	1./7	Mer ujerat e rruges dytesore dhe te Autostrades	0.562		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203		0.9	0.3	
	1/7-5/6	90 m e para	1.866		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203		0.8	0.8	
	1/7-5/6	70 m e dyta	2.831		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203		0.8	1.3	
	1/7-5/6	75 m e tereta	3.931		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203		0.8	1.8	
	1/7-5/6	60 m e katerta	4.371		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203		0.8	2.0	
1/8-5/5	1./8	Hyrje, Mer Ujerat e Perroit te Xhedinit, Autostrades dhe Rruges Dytesore	37.58		26	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	59	145	0.5		7.6
	1/8-5/5		40.62	296	29.3	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	54	133	0.55		8.2
5/5-5/6		Merr Perroin e Xhedinit dhe Segmentin 5/5-5/6	40.924	87	30.3	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	53	129	0.6		8.8

5/6-5/7		Merr Perroin e Xhedinit dhe Segmentin 5/5-5/6 dhe 5/7	41.22	102	31.4	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	51	126	0.62		8.9
5/7-5/8		Merr Perroin e Xhedinit dhe Segmentin 5/5-5/6 dhe 5/7 dhe 5/8	41.93	110	32.6	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	50	122	0.65		9.3
1/6-5/8	1./6	Mer ujerat e rruges dytesore dhe te Autostrades	0.8656		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203	509	0.9	0.4	
	1/6-5/8	90 m e para	2.7526	90	6.0	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	177	443	0.8	1.1	
		65 m e dyta	4.1136	65	6.7	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	163	406	0.8	1.5	
		75 m e treta	5.6566	75	7.6	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	149	372	0.8	1.9	
		55 m e katerta	5.8146	55	7.9	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	144	359	0.8	1.9	
5/8-5/9			48.9966	189	34.7	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	47	117	0.76		12.1
5/9-6.			61.7852	205	37.0	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	45	111	0.78		14.9
5/5-5/4			0.751		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203	509	0.8	0.3	
1/9-5/4	1./9	Hyrrje Mer Perroin Djeri I Gjuzit (eshte llogaritur prerja e plotes tek rezervuari)	89.244		36	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	46	113	0.53		5.2
	1/9-5/4	60 m e para	1.08	60	36.7	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	45	112	0.56		5.4
		60 m e dyta	2.341	60	37.3	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	45	110	0.58		5.6
		80 m e treta	3.895	80	38.2	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	44	108	0.6		5.7
		80 m e katerta	4.915	80	39.1	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	43	107	0.62		5.8
5/4-5/2			7.13	368	43.2	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	40	99	0.67		6
5/2-5/1			14.716	197	45.4	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	39	95	0.7		8.7
5/1-5.			19.616	183	47.4	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	37	92	0.75		9.8

3/5.		Hyrrja Kanali qe kalon poshte nenkalimit te Golemit	41.81		28.6	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	55	135	0.7	3.4	
		deri tek pika 5	45.71	188	30.7	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	52	128	0.75	4.9	
5/1-10/1-10			1.23		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203	509	0.8	0.6	
9/2-10.			0.73		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203	509	0.8	0.3	
5-10.			22.566	95	48.5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	37	90	0.75		11.6
10/1-10/2			1.18		5	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	203	509	0.8	0.5	
10-Det			34.406	150	50.1	Durres	69.0	0.248	165.0	0.24	36	88	0.75		12.8

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIA DEVELOPMENT FUND

RIKUALIFIKIM URBAN I ZONËS TURISTIKE, GOLEM - LOT I

Aneksi C – Llogaritjet Strukturore

Shtator, 2020

KONSULENTI: ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS

Porositësi:	**Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
Konsulenti:	**Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.**
Objekti:	**Rikualifikim Urban i Zonës Turistike, Golem - Lot I**
Titulli i Dokumentit:	**Aneksi C – Llogaritjet Strukturore**
Faza e Projektit:	**Projekt Zbatimi**
Kodi i dokumentit:	**ICE-287-P01-V1 03**

Rish.	**Qëllimi i Dorëzimit**	**Shënime**	**Data**
00	Për miratim	Dorëzimi i parë	26.09.2020

	KONSULENTI			**POROSITËSI**	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Taulant Karriqi	Olset Haxhiu Blenard Durmishi			
Data:	22.09.2020	25.09.2020	25.09.2020		
Statusi i Dokumentit:	**Përfundimtar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**

Tiranë 2020

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja ..... **i**
Lista e Tabelave ..... **iii**
Lista e Figurave ..... **iv**
1 Hyrje **1**
2 Konsideratat për Projektimin Strukturor dhe kriteret e Projektimit **2**
2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknikë 2
2.2 Veprimet 2
2.2.1 Pesha Vetjake dhe Veprimet e Përhershme 3
2.2.2 Ngarkesat e Përkohshme në Ura 4
2.2.3 Veprimi Sizmik 6
2.3 Projektimi në Gjendjen e Fundit Kufitare dhe Faktorët e Sigurisë 6
2.3.1 Gjendja Kufitare e Fundme 6
2.3.2 Gjendja Kufitare e Shërbyeshmërisë 9
2.3.3 Projektimi Gjeoteknik 10
2.4 Materialet e Përdorura për Strukturat prej Betoni 11
2.4.1 Betoni 11
2.4.2 Çeliku i Armimit 19
3 Analiza strukturore e kanalit të prroit të Agait **21**
3.1 Gjeometria e kanalit 21
3.2 Shtresa mbrojtëse e betonit 22
3.3 Ngarkesat 23
3.3.1 Ngarkesa e përhershme e elementeve strukturorë 23
3.3.2 Ngarkesa e përkohshme 23
3.3.3 Presioni i dheut 23
3.3.4 Presioni i ujit nëntokësor 24
3.3.5 Veprimi i temperaturës 24
3.3.6 Ngarkesa nga tërmeti 24
3.3.7 Kombinimet e ngarkesave 26
3.4 Rezultatet e analizës 28
4 Analiza strukturore e kanalit (2.0x2.0)m **35**
4.1 Shtresa mbrojtëse e betonit 35
4.2 Ngarkesat 37
4.2.1 Ngarkesa e përhershme e elementeve strukturorë 37
4.2.2 Ngarkesa e përkohshme 37
4.2.3 Presioni i dheut 37
4.2.4 Presioni i ujit nëntokësor 38
4.2.5 Veprimi i temperaturës 38
4.2.6 Ngarkesa nga tërmeti 38
4.2.7 Kombinimet e ngarkesave 40
4.3 Modeli strukturor i kanalit 42
4.4 Moduli i sustës së bazamentit 42
4.5 Rezultatet e analizës 42

Aneksi A: Llogaritjet strukturore të kanalit të Agait 43
A.1 Përcaktimi i rezistencës minimale të betonit dhe shtresës mbrojtëse 43
A.2 Llogaritja e soletës b/a të kanalit 44
A.3 Llogaritja e trarëve b/a të kanalit 45
A.4 Llogaritja e kolonave b/a të kanalit 48
A.5 Llogaritja e pllakës b/a të kanalit 49
Aneksi B: Llogaritjet strukturore të kanalit (2.0x2.0)m 51
Aneksi C: Llogaritjet e kanalit me palankola çeliku 61
Referencat 70
Literatura 71

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1: Dendësia nominale e materialeve të ndërtimit 3
Tabela 2-2: Ngarkesa e automjeteve sipas EN 1991-2 4
Tabela 2-3: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi ura 7
Tabela 2-4: Vlerat e faktorit ψ 7
Tabela 2-5: Vlerat llogaritëse γ të veprimit 8
Tabela 2-6: Vlerat projektuese të veprimeve për situatat me ngarkesa aksidentale dhe sizmike 9
Tabela 2-7: Kombinimi i veprimeve për SLS 9
Tabela 2-8: Vlerat projektuese të veprimeve të përdorura në kombinimet e veprimeve 9
Tabela 2-9: Faktorët e sigurisë për gjendjen kufitare të fundme për projektimin gjeoteknik 10
Tabela 2-10: Vlerat kufi të rekomanduara për përbërjen e betonit për urat dhe strukturat e tjera 13
Tabela 2-11: Klasat e uljes 17
Tabela 2-12: Vlerat e shtresës minimale mbrojtëse (Eurokodi 2 Tabela 4.4N) 17
Tabela 2-13: Diametri maksimal i shufrave për kontrollin e plasaritjeve 20
Tabela 3-1: Vlera kufizuese të rekomanduara për përbërjen e betonit (EN 206:2013) 22
Tabela 3-2: Rastet e ngarkesave 23
Tabela 3-3: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e përhershme) 26
Tabela 3-4: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e ndryshueshme) 26
Tabela 3-5: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, EQU (Set A) 26
Tabela 3-6: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, STR/GEO (Set B) 27
Tabela 3-7: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, STR/GEO (Set C) 27
Tabela 3-8: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, Sizmik 27
Tabela 3-9: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, Aksidental 27
Tabela 3-10: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, Karakteristik 27
Tabela 3-11: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, I shpeshtë 28
Tabela 3-12: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, I shpeshtë 28
Tabela 4-1: Vlera kufizuese të rekomanduara për përbërjen e betonit (EN 206:2013) 36
Tabela 4-2: Rastet e ngarkesave 37
Tabela 4-3: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e përhershme) 40
Tabela 4-4: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e ndryshueshme) 40
Tabela 4-5: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, EQU (Set A) 40
Tabela 4-6: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, STR/GEO (Set B) 40
Tabela 4-7: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, STR/GEO (Set C) 41
Tabela 4-8: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, Sizmik 41
Tabela 4-9: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, Aksidental 41
Tabela 4-10: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, Karakteristik 41
Tabela 4-11: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, I shpeshtë 41
Tabela 4-12: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, I shpeshtë 42

LISTA E FIGURAVE

Figura 2-1: Detaje të modelit të ngarkimit 1 (LM1) për ngarkesat e trafikut 5
Figura 2-2: Aplikimi i sistemit "tandem" për kontrolle lokale 5
Figura 2-3: Klasat e ekspozimit mjedisor 12
Figura 2-4: Shtresa mbrojtëse nominale c_{nom} 13
Figura 2-5: Diagrama sforcim – deformacion për beton C30/37 në shtypje 18
Figura 2-6: Diagrama sforcim – deformacion për beton C45/55 në shtypje 18
Figura 2-7: Çeliku i armimit B500C – diagrama sforcim-deformacion e projektimit 19
Figura 3-1: Pamje e modelit me elemente të fundëm të strukturës së kanalit në SAP2000 21
Figura 3-2: Tregues i shenjave (+,-) të veprimit sizmik 25
Figura 3-3: Presioni i dheut nga veprimi sizmik 26
Figura 3-4: Pamje e seksionit tërthor të strukturës së kanalit 28
Figura 3-5: Rasti i ngarkesës së presionit horizontal nga uji nëntokësor [kN,m] 29
Figura 3-6: Presioni horizontal i dheut [kN,m] 29
Figura 3-7: Sforcimet në bazament nga kombinimi maksimal për ULS [kN,m] 30
Figura 3-8: Momenti maksimal M1-1 për ULS në soletën 20cm [kNm/m] 30
Figura 3-9: Momenti maksimal M2-2 për ULS në soletën 20cm [kNm/m] 31
Figura 3-10: Momenti maksimal M3-3 për ULS në në trarët e kanalit [kNm] 31
Figura 3-11: Forca prerëse V2-2 për ULS në në trarët e kanalit [kN] 32
Figura 3-12: Forca aksiale për ULS në në kolonat e kanalit [kN] 32
Figura 3-13: Forca prerëse M2-2 për ULS në në kolonat e kanalit [kN] 33
Figura 3-14: Forca prerëse M3-3 për ULS në në kolonat e kanalit [kN] 33
Figura 3-15: Përmasat e seksionit tërthor të kanalit të Agait [cm] 34
Figura 3-16: Armimi në seksionin tërthor të kanalit të Agait [mm, cm] 34
Figura 4-1: Pamje 3D e kanalit (2.0x2.0)m 35
Figura 4-2: Tregues i shenjave (+,-) të veprimit sizmik 38
Figura 4-3: Presioni i dheut nga veprimi sizmik 39
Figura 4-4: Armimi i kanalit (2.0x2.0)m 42

1 HYRJE

Shoqëria "Illyrian Consulting Engineers" sh.p.k. në cilësinë e Konsulentit ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kontratën me objekt: "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë".

Ky raport paraqet llogaritjet dhe projektimin veprave strukturore të projektit "Studim Projektim i Zonës Turistike Golem, Kavajë".

Llogaritjet nga ana strukturore janë bazuar në normat teknike Shqiptare, KTP dhe në standardet europiane Eurocode. Struktura e veprave janë planifikuar me elemente betonarme, kryesisht të klasës C30/37. Çeliku i armimit do të jetë i klasës B500C. Veprat strukturore janë optimizuar si nga ana materiale po ashtu dhe funksionele. Ato do të mbështeten mbi një shtresë zhavorri 15cm dhe një shtrese 10 cm prej betoni të varfër C12/15. Mbushja anash kanaleve do të me çakëll me ngjeshje 98% MDD. Struktura

2 KONSIDERATAT PËR PROJEKTIMIN STRUKTUROR DHE KRITERET E PROJEKTIMIT

2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknikë

Në këtë kapitull janë dhënë kodet, standardet dhe dokumentet teknike më të rëndësishme të cilat janë ndjekur dhe respektuar gjatë procesit të projektimit.

Projektimi i urave do të bëhet në përputhje me Rregullat Teknikë të Projektimit Rrugëve (RrTPRr-5_ - Urat dhe Tunelet si dhe normat Evropiane (Eurocodes).

Projektimi dhe ndërtimi i të gjithë zërave sipas fushave përkatëse përmbushin kërkesat e botimeve dhe rishikimeve më të fundit të kodeve dhe standardeve të organizmave teknike të mëposhtme:

- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet mbi struktura
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave prej betoni
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit
- KTP 2-78 Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-98 Kushtet teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (norma teknike për projektimin e strukturave anti-sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP 4-78 Kategorizimi dhe klasifikimi i veprave hidroteknike
- KTP 7-78 Përcaktimi i ngarkesës se erës
- KTP 8-78 Përcaktimi i ngarkesës se dëborës

Në Eurokodet strukturorë, kërkesat e projektimit jepen në lidhje me kushtet specifike të gjendjeve kufitare. Llogaritjet për të përcaktuar aftësinë e pjesëve të ndryshme për të përmbushur një gjendje të veçantë kufitare janë bërë duke përdorur veprimet llogaritëse (ngarkesa dhe deformime) dhe rezistencat llogaritëse. Vlerat llogaritëse janë përcaktuar nga vlerat përkatëse të veprimeve dhe rezistencat karakteristike të materialeve nëpërmjet aplikimit të faktorëve të sigurisë.

2.2 Veprimet

Veprimet janë marrë nga pjesët e mëposhtme të EN 1991 dhe EN 1998:

- EN 1991-1-1 Dendësia, pesha vetjake dhe ngarkesa e përkohshme
- EN 1991-1-5 Veprimet termike
- EN 1991-1-6 Veprimet gjatë ndërtimit
- EN 1991-1-7 Veprime aksidentale për shkak të goditjeve dhe shpërthimeve
- EN 1991-2 Ngarkesat e trafikut në ura
- EN 1991-3 Veprimet nga vinçat dhe makineritë
- EN 1997 Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8 (Pjesa 1 dhe 5) Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit

Një veprim i ndryshueshëm ka vlerat e mëposhtme përfaqësuese:

- Vlera karakteristike Q_k
- Vlera e kombinimit $\psi_0 Q_k$
- Vlera e shpeshte $\psi_1 Q_k$
- Vlera pothuajse e përhershme $\psi_2 Q_k$

Vlerat karakteristike dhe vlerat e kombinimeve përdoren për verifikimin e gjendjes së fundit kufitare dhe kontrollin në gjendjen e fundit të pakthyeshme të shërbyeshmërisë. Vlerat e shpeshta dhe pothuajse të përhershme përdorën për kontrollin e gjendjes së fundit kufitare duke përfshirë dhe veprimet aksidentale dhe gjendjen e fundit të kthyeshme të shërbyeshmërisë. Vlerat pothuajse të përhershme përdorën gjithashtu për llogaritjen e veprimeve me kohë të gjatë.

Vlerat projektuese të veprimeve (ngarkesave) jepen nga:

$$\text{Veprimi (ngarkesa) llogaritëse} = \gamma_F \times \psi F_k$$

ku F_k është vlera karakteristike e specifikuar, γ_F është vlera e faktorit të sigurisë për veprimin (γ_A për veprimet aksidentale, γ_G për veprimet e përhershme, γ_Q për veprimet e ndryshueshme) dhe gjendjen kufitare të marrë në konsideratë, dhe ψ është 1.0, ψ_0, ψ_1 ose ψ_2. Vlerat e rekomanduar të γ_F dhe ψ jepen në EN 1990 Bazat e projektimit strukturor.

Vlerat projektuese të veprimeve janë marrë nga faktorët pjesorë γ_F dhe janë kombinuar ndërmjet tyre sipas situatës projektuese, duke përmenduar kryesisht tre tipe:

- situatë e qëndrueshme projektim, e cila i referohet kushteve të përdorimit normal;
- situatë kalimtare projektimi, e cila u referohet kushteve të përkohshme të ushtruara në strukturë, p.sh. gjatë zbatimit ose riparimit;
- situatë kalimtare projektimi, e cila u referohet kushteve të jashtëzakonshme të ushtruara në strukturë ose gjatë ekspozimit të saj.

2.2.1 Pesha Vetjake dhe Veprimet e Përhershme

Pesha vetjake e strukturës dhe komponentëve të saj llogaritet në përputhje me EN 1991 në bazë të përmasave nominale dhe vlerave karakteristike të dendësive të dhëna në EN 1991 – 1, Aneksi A – Tabelat për dendësinë nominale të materialeve të ndërtimit, dhe dendësia nominale dhe këndet e vendosjes për materialet e ruajtura. Më poshtë jepen vlerat nominale të dendësisë së materialeve të përdorura:

Tabela 2-1: Dendësia nominale e materialeve të ndërtimit

Materiali	Dendësia Nominale (kN/m^3)
Betoni (pesha normale, i pa-armuar)	24.0
Betoni (pesha normale, i armuar)	25.0
Llaç – çimento	23.0
Çelik	78.5
Zhavorr	19.0

Si ngarkesa të përhershme janë konsideruar:

- Ngarkesa nga pesha vetjake e elementeve strukturorë

- Ngarkesa nga pesha vetjake e elementeve jo-strukturorë
- Ngarkesa nga shtresat e vijës së kalimit
- Ngarkesa nga instalimet e pajisjeve të ndryshme

2.2.2 Ngarkesat e Përkohshme në Ura

Projektimi i urave do të bëhet në përputhje me Rregullat Teknikë të Projektimit Rrugëve (RrTPRr-5_ - Urat dhe Tunelet si dhe normat Evropiane (Eurokodet).

Për përcaktimin e efekteve të ngarkesës së trafikut, merren në konsideratë ngarkesat karakteristike të lidhura me verifikimin sipas gjendjes së fundit kufitare (ULS) dhe në raste të veçanta me gjendjen e shërbyeshmërisë (sipas EN 1990 deri në EN 1999).

Si ngarkesa të përkohshme janë konsideruar:

- Ngarkesa vertikale nga automjetet lëvizëse
- Forca e frenimit nga automjetet lëvizëse
- Ngarkesa vertikale nga turma (këmbësorët)

2.2.2.1 Ngarkesa vertikale nga automjetet lëvizëse

Vlerat karakteristike të ngarkesave të përqendruara dhe të shpërndara të trafikut sipas LM1, jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2-2: Ngarkesa e automjeteve sipas EN 1991-2

Pozicioni	**Ngarkesa e Përqendruar për makina me 2 akse**	**Ngarkesa Njëtrajtësisht e Shpërndarë**
	Ngarkesa aksiale Q_{ik} (kN)	**q_{ik} (kN/m^2)**
Korsia Nr.1	300	9
Korsia Nr.2	200	2,5
Korsia Nr.3	100	2,5
Korsi të tjera	0	2,5
Zona e mbetur (q_{rk})	0	2,5

Detajet e modelit të ngarkimit 1 jepen në figurën e mëposhtme:



*)Për $w_1 = 3.00m$

Figura 2-1: Detaje të modelit të ngarkimit 1 (LM1) për ngarkesat e trafikut

Vlerat e ngarkesave aksiale nënkuptojnë që të kemi dy rrota identike me ngarkesë $0{,}5\alpha_{Qi}Q_{ik}$ secila. Vlerat e faktorëve korrigjues α_{Qi}, α_{qi} dhe α_{qr} do të merren të barabartë me njësinë ($\alpha = 1$). Sipërfaqja e kontaktit të secilës gomë do të merret (0,4x0,4) m.

Për kontrolle lokale aplikohet një sistem "tandem" në pozicionin më të disfavorshëm. Në rastin kur merren në konsideratë dy sisteme "tandem" në korsitë imagjinare fqinje atëherë ata mund të merren afër, me një distancë midis akseve jo më pak se 0.50m.



Figura 2-2: Aplikimi i sistemit "tandem" për kontrolle lokale

2.2.2.2 Ngarkesa nga turma

Referuar Eurokodit kjo ngarkesë është marrë e barabartë me 5 kN/m^2.

2.2.2.3 Ngarkesa nga forca e frenimit

Sipas Eurokodit 1991-2 forca e frenimit për automjet lëvizëse llogaritet:

$180\alpha_{Q1}$ (kN) $\le F_f = 0{,}6\ \alpha_{Q1}\ (2Q_{1k}) + 0{,}10 \cdot q_{1k} \cdot w_1 \cdot L \le 900$ kN

$F_f = 0.6 \cdot (2 \cdot 300) + 0.10 \cdot 9 \cdot 3 \cdot 24.1 = 360 + 65.1 = 425.1$ kN

2.2.3 Veprimi Sizmik

Për projektimin e urë, do të përdoret spektri që jepet në Eurokodin 8 (EN 1998-1). Sipas EN 1998-2 klasa e rëndësisë për strukturën e urës së këtij projekti klasifikohet në: Klasa e rëndësisë II: Rëndësi mesatare, që i korrespondon një faktor rëndësie: $\gamma_I = 1.0$

- Nxitimi maksimal i truallit për truall të tipit A është: a_{gR}=0.21g (sipas "Studimit sizmik")
- Vlera projektuese e veprimit sizmik është: $a_g = \gamma_I \times a_{gR} = 1.0 \times 0.210g = 0.210g$

2.3 Projektimi në Gjendjen e Fundit Kufitare dhe Faktorët e Sigurisë

Në kodet strukturore Evropiane, përdoret koncepti i projektimit sipas gjendjes kufitare. Janë marrë në konsideratë: Gjendja Kufitare e Fundme (ULS – Ultimate Limit State) dhe Gjendja Kufitare e Shërbyeshmërisë (SLS – Serviceability Limit State), si edhe Durueshmëria. Faktorët e sigurisë janë përfshirë si në ngarkesat llogaritëse ashtu dhe në rezistencat e materialeve, për të siguruar shmangien e shkatërrimit (p.sh., mos përmbushja e një prej kërkesave të projektimit). Elementet janë llogaritur si fillim për të përmbushur gjendjen kufitare më kritike dhe me pas kontrollohen për të siguruar që gjendjet e tjera kufitare të mos arrihen.

Për shumicën e elementëve strukturor, gjendja kritike e marrë në konsideratë është ULS-ja, në të cilën është bazuar rezistenca e kërkuar e elementëve në përkulje, prerje dhe përdredhje. Kërkesat e gjendjeve të ndryshme SLS, siç mund të jetë deformimi apo plasaritjet, janë konsiderohen pas këtij procesi.

Duke qenë se raporti i përshtatshëm i hapësirës me lartësinë efektive të elementeve (për të mënjanuar deformimet e tepërta) dhe zgjedhja e një hapi të përshtatshëm midis shufrave (për të mënjanuar plasaritjet e tepërta), ndikohen nga niveli i sforcimeve në armaturë, projektimi sipas gjendjes kufitare është një proces interaktiv. Megjithatë, është normale që të niset me kërkesat e gjendjes ULS.

2.3.1 Gjendja Kufitare e Fundme

Veprimet projektuese që duhet të merren në konsideratë për projektimin strukturor tregohen në tabelën e mëposhtme. Është përdorur ekuacioni Ek. 6.10 ose ekuacionet më pak të favorshme Ek. 6.10a dhe Ek. 6.10b. Për opsionin 2b, vlera e koeficientit të sigurisë kur ngarkesa është e pafavorshme për veprimet e përhershme jepet nga $\xi\gamma_G = 0.85 \times 1.35 = 1.15$. Për të gjitha veprimet e përhershme nga i njëjti burim, për shembull, pesha vetjake e strukturës, duhet të përdoret në të gjitha pjesët qoftë vlera e favorshme dhe e pafavorshme. Kur veprimet e ndryshueshme janë të favorshme, do të përdoret vlera $Q_k = 0$. Aty ku është e nevojshme, secila ngarkesë e ndryshueshme me radhë do të konsiderohet si ngarkesë kryesore. Nëse $Q_{k,1}$ lidhet me një zonë magazinimi, për të cilën $\psi_0 = 1.0$, Ek. 6.10 dhe Ek. 6.10a janë identike. Në raste të tjera, është me avantazh të përdoret Ek. 6.10a/b, ku Ek. 6.10b aplikohet për vlera të $G_k \leq 4.5Q_k$ kur $\psi_0 = 0.7$, dhe për vlera të $G_k \leq 7.5Q_k$ kur $\psi_0 = 0.5$.

Gjendja kufitare e fundme do të kontrollohet si më poshtë:

a. EQU: Humbja e ekuilibri statik të strukturës ose të ndonjë pjese të saj të konsideruar si një trup i ngurtë.
b. STR: Humbja e qëndrueshmërisë ose deformime të tepërta të strukturës ose elementeve të saj, duke përfshirë plintat, pilotat, muret e bodrumit, etj.
c. GEO: Humbja e qëndrueshmërisë ose deformime të mëdha të truallit ku rezistenca e dheut ose shkëmbit nuk janë të mjaftueshme për të siguruar qëndrueshmërinë.

Për gjendje kufitare të ekuilibrit statik të strukturës (EQU), kontrollohet që:

$$E_{d,dst} \leq E_{d,stb}$$

ku:

$E_{d,dst}$: është vlera projektuese e veprimeve destabilizuese;

$E_{d,stb}$: është vlera projektuese e veprimeve stabilizuese.

Për gjendjen kufitare të thyerjes ose deformimeve të tepërta të një seksioni, elementi apo lidhje (STR dhe/ose GEO), kontrollohet që:

$$E_d \leq R_d$$

ku:

E_d: është vlera projektuese e një faktori si p.sh. forcë e brendshme, moment ose vektor që përfaqëson disa forca të brendshme ose momente;

R_d: është vlera projektuese e rezistencës përkatëse.

Kombinimet e veprimeve projektuese që janë marrë në konsideratë dhe vlerat e faktorit ψ që janë përdorur tregohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2-3: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi ura

Gjendja e Kufitare e Fundme (ULS)	Kombinimi i Veprimeve (shiko EN 1990)
Veprime të vazhdueshme dhe kalimtare (Ek. 6.10)	$\Sigma\gamma_{G,j}\, G_{k,j}$ "+" $\gamma_P\, P$ "+" $\gamma_{Q,1}\, Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\gamma_{Q,i}\, \psi_{0,i}\, Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i > 1)
Veprime të vazhdueshme dhe kalimtare, përveç gjendjes kufitare STR dhe GEO, më pak e favorshmja midis (Ek. 6.10a or 6.10b)	$\Sigma\gamma_{G,j}\, G_{k,j}$ "+" $\gamma_P\, P$ "+" $\gamma_{Q,1}\, \psi_{0,1}\, Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\gamma_{Q,i}\, \psi_{0,i}\, Q_{k,i}$ (6.10a) $\Sigma\xi_j\gamma_{G,j}\, G_{k,j}$ "+" $\gamma_P\, P$ "+" $\gamma_{Q,1}\, Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\gamma_{Q,i}\, \psi_{0,i}\, Q_{k,i}$ (6.10b) (j ≥ 1, i > 1)
Kombinimi për Gjendjen e Fundme (Veprim aksidental)	A_d "+" P "+" $\Sigma G_{k,j}$ "+" ($\psi_{1,1}$ or $\psi_{2,1}$) $Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\psi_{2,i}Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i > 1)
Kombinimi për Gjendjen e Fundme (Veprim sizmik)	$\Sigma G_{k,j}$ "+" P "+" A_{Ed} "+" $\Sigma\psi_{2,i}\, Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i ≥ 1)
Shënim: "+" nënkupton "të kombinohet me", Σ nënkupton "efekti i kombinuar i", ξ është koeficienti i zvogëlimit për ngarkesat e përhershme jo të favorshme G.	

Tabela 2-4: Vlerat e faktorit ψ

Veprimi	Simboli		ψ_0	ψ_1	ψ_2
Ngarkesat e trafikut (EN 1991-2, Tabela 4.4)	gr 1a (LM1+këmbësorët ose gr 1a (LM1+këmbësorë ose korsia e biçikletave)[1)]	TS	0.75	0.75	0
		UDL	0.40	0.40	0
		Ngarkesa e korsisës së këmbësorëve+biçikletave[2)]	0.40	0.40	0
	gr 1b (një aks i vetëm)		0	0.75	0
	gr 2 (forca horizontale)		0	0	0
	gr 3 (ngarkesat e këmbësorëve)		0	0.4	0
	gr 4 (LM-4 ngarkesat e turmës)		0	-	0
	gr 5 (LM-3 automjetet speciale)		0	-	0
Forcat e erës	F_{wk} – Situata të qëndrueshme projektimi		0.6	0.2	0
	F_{wk} – Zbatimi		0.8	-	0
	F_w		1.0	-	-
Veprimet termike	T_k		0.6[3)]	0.5	0.5
Ngarkesat e borës	$Q_{Sn,k}$ (gjatë zbatimit)		0.8	-	-
Ngarkesat gjatë ndërtimit	Q_c		1.0	-	1.0

1) Vlerat e rekomanduara të ψ_0,ψ_1 dhe ψ_2 për gr1a dhe gr1b janë dhënë për trafik rrugor që korrespondon me faktorë rregullues α_{Qi}, α_{qi}, α_{qr} dhe β_Q të barabartë me 1. Ato që lidhjen me UDL-në korrespondojnë me skenarët e zakonshëm të trafikut, në të cilët mund të ndodhë një grumbullim i rrallë i kamionëve. Vlera të tjera mund të konsiderohen për klasat e tjera të intinerareve, ose për trafik të pritur, lidhur me zgjedhjen e faktorëve α korrespondues. Për shembull, një vlerë e ψ_2 ndryshe nga zero mund të konsiderohet për sistemin UDL vetëm të LM1, për ura që përballojnë trafik të rëndë e të vazhduar. Shih gjithashtu EN 1998.
Vlera të tjera mund të parashikohen për klasa të tjera të rrugëve ose të trafikut të pritur, lidhur me zgjedhjen e faktorëve α korrespondues. Për shembull, një vlerë e ψ_2 ndryshe nga zero mund të parashikohet për sistemin UDL vetëm të LM1, për ura që përballojnë trafik të rëndë e të vazhduar. Shih gjithashtu EN 1998.
2) Vlera e kombinimit e ngarkesës së korsisë së këmbësorëve dhe të biçikletave, e përmendur në Tabelën 4.4a të EN 1991-2, është një vlerë e "reduktuar". Faktorët ψ_0 dhe ψ_1 janë të aplikueshëm ndaj kësaj vlere.
2) Vlera e kombinimit e ngarkesës së korsisë së këmbësorëve dhe të biçikletave, e përmendur në Tabelën 4.4a të EN 1991-2, është një vlerë e "reduktuar". Faktorët ψ_0 dhe ψ_1 mund t'i aplikohen kësaj vlere. Faktorët ψ_0 dhe ψ_1 janë të aplikueshëm për këtë vlerë.
3) Vlera e rekomanduar e ψ0 për veprime termike në shumë raste mund të reduktohet në 0 për gjendje të fundit kufitare EQU, STR dhe GEO. Shih gjithashtu Eurokodet e projektimit.
3) Vlera e rekomanduar e ψ_0 për veprime termike në shumicën e rasteve mund të reduktohet në 0 për gjendje të fundit kufitare EQU, STR dhe GEO. Shih gjithashtu Eurokodet e projektimit.

Tabela 2-5: Vlerat llogaritëse *γ* të veprimit

Kombinimi	EN 1990	Veprime të përhershme		Parasforcimi	Veprimi i ndryshueshme kryesor	Veprime të ndryshueshme	
		Të pafavorshme	Të favorshme			Kryesori (nëse ka)	Të tjerë
		$\gamma_{Gj,sup}G_{kj,sup}$	$\gamma_{Gj,inf}G_{kj,inf}$	$\gamma_P P$	$\gamma_{Q,1}Q_{k,1}$	$\gamma_{Q,1}\psi_{0,1}Q_{k,1}$	$\gamma_{Q,i}\psi_{0,i}Q_{k,i}$
EQU (Seti A)	Ekuacioni 6.10	1.05 1.35	0.95 1.25		1.35 (0 ku është i favorshëm)	-	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti B)	Ekuacioni 6.10	1.35	1.00		1.35 (0 ku është i favorshëm)	-	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti B)	Ekuacioni 6.10a	1.35	1.00		-	1.50 (0 ku është i favorshëm)	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti B)	Ekuacioni 6.10b	$\gamma_{Gj,sup}$=1.35 ξ = 0.85	1.00		1.35 (0 ku është i favorshëm)	-	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti C)	Ekuacioni 6.10b	1.00	1.00		1.15 (0 ku është i favorshëm)	-	1.30 (0 ku është i favorshëm)

Koeficientet e kombinimit e veprimeve për gjendjen kufitare të fundme në projektimin për situatat me ngarkesat aksidentale dhe sizmike (shprehja 6.11a deri tek 6.12b në EN 1990) janë 1,0. Vlerat e faktorit ψ jepen në EN 1990, Tabela A2.1.

Tabela 2-6: Vlerat projektuese të veprimeve për situatat me ngarkesa aksidentale dhe sizmike

Kombinimi	EN 1990	Veprimi i përhershëm		Parasforcimi	Ngarkesa kryesore aksidentale ose sizmike	Veprimi i ndryshueshëm	
		I pafavorshëm	I favorshëm			Kryesor (nëse ka)	Të tjerë
Aksidental	6.11a/b	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	P	A_d	$\psi_{1,1}\ Q_{k,1}$ ose $\psi_{1,1}Q_{k,1}$	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$
Sizmik	6.12a/b	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	P	$\gamma_I A_{Ek}$ or A_{Ed}	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$	
Shënim: Në rastet e situatave të kombinimit aksidental, veprimi kryesor i ndryshueshëm mund të merret me vlerën e tij më të shpeshtë, si në rastin e kombinimit sizmik me vlerën e tij pothuaj të përhershme.							

2.3.2 Gjendja Kufitare e Shërbyeshmërisë

Është kontrolluar që:

$$E_d \leq C_d$$

Ku:

C_d: është vlera kufitare e projektimit për kriterin përkatës të shërbyeshmërisë;

E_d: është vlera projektuese e veprimeve të specifikuara në kriterin e shërbyeshmërisë, e përcaktuar në bazë të kombinimit përkatës.

Tabela 2-7: Kombinimi i veprimeve për SLS

Gjendja kufitare e shërbyeshmërisë (SLS)	Kombinimi i veprimeve (shiko EN 1990)
Kombinimi karakteristik (funksioni, përfshirë dëmtimet e elementeve strukturore dhe jo strukturore, p.sh. muret ndarëse)	$\Sigma G_{k,j}$ "+" P + $Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\psi_{0,i}\ Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i > 1)
Kombinimi i shpeshtë (përdorimi i makinerive, shmangia e pellgjeve të ujit, etj.)	$\Sigma G_{k,j}$ "+" P "+" $\psi_{1,1}\ Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\psi_{2,i}\ Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i > 1)
Kombinimi pothuajse i përhershëm (pamja)	$\Sigma G_{k,j}$ "+" P "+" $\Sigma\psi_{2,i}\ Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i ≥ 1)
Shënim: "+" nënkupton "të kombinohet me", Σ nënkupton "efekti i kombinuar i", ξ është koeficienti i zvogëlimit për ngarkesat e përhershme jo të favorshme G.	

Për gjendjen kufitare të shërbyeshmërisë faktori i pjesshëm është marrë 1,0 përveç rastit kur specifikohet ndryshe nga EN 1991 deri në EN 1999.

Tabela 2-8: Vlerat projektuese të veprimeve të përdorura në kombinimet e veprimeve

Kombinimi	Veprimi i përhershëm		Parasforcim	Veprimi i ndryshueshme	
	I pafavorshëm	I favorshëm		Kryesori	Të tjerë
Karakteristik	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	P	$Q_{k,1}$	$\psi_{0,i}Q_{k,i}$
I shpeshtë	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	P	$\psi_{1,1}Q_{k,i}$	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$
Pothuajse i përhershëm	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	P	$\psi_{2,1}Q_{k,i}$	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$

2.3.3 Projektimi Gjeoteknik

Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik jep një përmbledhje të kërkesave për projektimin e strukturave gjeoteknike. Ai i klasifikon strukturat në tre kategori sipas kompleksitetit të tyre dhe rrezikut që lidhet me to, por përqendrohet dhe në projektimin e strukturave konvencionale pa rreziqe të jashtëzakonshme. Këto përfshijnë themelet e veçantë, të tipit pllakë dhe me pilota, struktura mbajtëse, pila të urave, argjinatura dhe tunele. janë marrë në konsideratë gjendjet kufitare të qëndrueshmërisë, rezistencës dhe shërbyeshmërisë. Kërkesat e gjendjes kufitare të fundme dhe asaj të shërbyeshmërisë mund të arrihen nëpërmjet disa metodave, veçmas ose në kombinim.

Metoda e llogaritjeve e adoptuar në këtë projekt për gjendjen kufitare të fundme është Qasja e Projektimit 1 (Design Approach 1): e cila kërkon marrjen në konsideratë të dy kombinimeve të faktorëve të sigurisë për veprimet dhe parametrat e dherave, siç tregohet në tabelën vijuese. Në përgjithësi, kombinimi 2 përcakton përmasën e përgjithshme të strukturës dhe kombinimi 1 përcakton projektimin strukturor të elementëve të ndryshëm. Parametrat karakteristike të dherave përcaktohen nga vlerësime të kujdesshme të vlerave që ndikojnë në ndodhjen e një gjendjeje kufitare. Si rrjedhim, për kombinimin 2, vlerat llogaritëse për rezistencën e dheut në gjendjen e fundit kufitare jepen nga:

$$\tan \phi'_d = (\tan \phi')/1.25 \text{ and } c'_d = c'/1.25$$

Tabela 2-9: Faktorët e sigurisë për gjendjen kufitare të fundme për projektimin gjeoteknik

Kombinimi	Faktori i sigurisë për Veprimet[a], γ_F		Faktori i sigurisë për parametrat e dherave, γ_M		
